Dukagjini "Nderi i Kombit"

Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIII i botimit, nr. 265, Nëntor 2025

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Demokracia qytetare nuk bëhet, nëse mungon toleranca...

7

GËZIM TUSHI
"Mjeshtër i Madh", "Kalores i Urdhrit te Skënderbeut"

Megjithëse kohët e fundit opinioni publik qytetar është sensibilizuar nga përballja me disa dukuri sociale shqetësuese, edhe pse nga politikanët, intelektualët, sociologët e psikologët është folur dhe shkruar shumë në median elektronike e atë të shkruar për situatën sociale të agravuar në Shqipëri, për nivelet e larta të dhunës, krimit, vrasjeve, neurotizmit social, sjelljeve të shëmtuara, dozave të forta të agresivitetit dhe mungesës së komunikimit qytetar, ende nuk janë të qarta deri në fund, që pse është kjo situatë kaq patologjike. Pse këto komunikime të vrazhdëta, veprime hakmarrëse, komportime antinormative?

TESTAMENT SHPIRTËROR I NJË JETE TË TËRË

Prof. Dr. MIGENA ARLLATI,
*autore e tekstit studimor**

Krijimtaria poetike e Tahir Bezhanit, tashmë e shtrirë në 28 vëllime, paraqet një univers të gjerë tematik dhe emocional, që lëviz midis kujtesës, dhimbjes, dashurisë dhe përjetësisë. Poezia e tij ndërtohet mbi përvojën njerëzore, historike dhe shpirtërore të një brezi që ka njohur humbjen, mërgimin dhe përpjekjen për ta ruajtur identitetin në një botë që [illegible]on pa mëshirë...

12

VRASJET TONA "DEMOKRATIKE"

Kolegu e miku im i vjetër, Musa Kurtllaj, dje zbuloi me trishtim nji shifër lufte të vrasjeve në Shqipninë postkomuniste. Statistikë e konfirmueme nga arkivat e Ministrisë së Brendshme, e publikue në media prej gazetarit Roland Qafoku.

Tmerr: 6652 vrasje "demokratike" prej vitit 1990 deri më 2025, që i bije një mesatare prej 190 trupash që i merri plumbi çdo vit.

Ja pra, "vrasjet tona demokratike" tridhjetëvjecare ua kalokan vrasjeve [illegible] "komuniste"...

3

Një vit i vështirë pa Luigj Shytin!

Të nderuar miq!

Të dashur familjarë e të afërm të Luigjit Shytit, anëtarë e bashkëpunëtorë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Sot jemi mbledhur këtu me respekt e mirënjohje të thellë, për të kujtuar me mall e krenari të ligjshme, një njeri shumë të veçantë, Luigj Gjergj Shytin, poetin, studiuesin, publicistin dhe mësuesin e përkushtuar të Dukagjinit. Një vit më parë, më 20 tetor 2024 ai u nda nga jeta në Torino të Italisë, mbas një sëmundjeje të gjatë e të rëndë. U bë gjithçka, brenda dhe jashtë vendit, që të shpëtohej jeta e tij, veçse qe e pamundur të arrihej. Por ai nuk u nda kurrë nga kujtesa dhe nga dashuria e njerëzve që e kishin të afërm, që e njohën dhe që bashkëpunuan me të.

Luigj Shyti lindi më 23 mars 1948 në Gjelaj të Thethit, në njërën prej degëve të fisit të njohur të Lul Gjokës, në një familje të ndershme, punëtore dhe me rrënjë të thella në traditat e zonës së Shalës. I biri i Gjergjit e Ages, i pari prej shtatë fëmijëve, i cili që në vogëli u dallua për zgjuarsi, për dije dhe vullnet të fortë për punë. Ishte nxënës i shkëlqyer, mbaroi shkollën 7-vjeçare në Theth me të gjitha notat maksimale. Jeta nuk i shtroi përpara rrugë të lehta Luigjit. Kushtet e vështira e detyruan të hyjë herët në punë, por kurrë nuk u largua nga kërkesa për dije. E filloi punën si mësues i thjeshtë, pastaj si drejtues shkolle, duke përhapur dije, kulturë e dashuri për arsimin në shumë fshatra të Dukagjinit: në Theth, Ndërlysa, Abat, Nicaj, Plan e Gur i Zi. Në çdo vend që shkeli, la pas kujtime të mira, një shkollë të rregullt, një komunitet më të ndriçuar mendërisht. Për kontribut të shquar në arsim e kulturë, në vitin 1987, u nderua me Urdhrin "Naim Frashëri".

Luigj Shyti ishte mësues nga profesioni, por në shpirt ishte poet dhe mendimtar. Që në rininë e hershme, nisi të shkruante, të hulumtonte, të mbante gjallë kujtesën e vendit të tij. Ai botoi qindra artikuj, studime e shkrime publicistike në gazeta e revista, si: "Jeta e Re", "Zëri i Rinisë", "Gegnia", "Shkodra", "Dukagjini", në të cilat trajtoi tema të arsimit, të traditave, të jetës shoqërore e shpirtërore të krahinës sonë. Vetëm në gazetën "Dukagjini" botoi mbi 190 artikuj. Në total, më shumë se 400 shkrime që mbeten sot pasuri kulturore e të gjithë Dukagjinit.

Por Luigji nuk u mjaftua me kaq. Në disa vite ai botoi 12 libra, që janë dëshmi e dashurisë së tij për Dukagjinin, për njerëzit e thjeshtë, për jetën e për gjuhën e bukur shqipe. Nga libri i parë "Dukagjini ka vend për të gjithë" i vitit 2005 e deri te romani "Blerta" në 2024-ën, ai nuk pushoi së shkruari, madje as atëherë kur jeta e përballi me sprovën më të madhe, me sëmundjen e rëndë.

Luigj Shyti ishte një ndër themeluesit dinjitoz të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe sekretari i saj që në ditët e para. Ai ishte ideatori dhe kryeredaktori i gazetës "Dukagjini", një zë i fuqishëm që bashkoi bijtë e kësaj krahine brenda dhe jashtë atdheut, një kambane e fortë që dëshmoi përpara të gjithë opinionit publik shkodranë e më gjerë se dukagjinasit nuk ishin ata që e prishnin, por që e nderonin qytetitin e tyre të lashtë. Kush ka qenë pranë tij ditën e parë kur doli gazeta, nuk i harron emocionet e tij ditën kur iu mbushën sytë me lot gëzimi, sepse për Luigj Shytin ajo gazetë ishte më shumë se një botim publicistik i zakonshëm, ishte zëri i shpirtit dhe i traditave më të mira të Dukagjinit. Ai ishte nismëtar i Konferencës "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin", nxitës i vendosjes së shtatores së Mehmet Shpendit në Shkodër dhe studiues i palodhur i historisë, i etnografisë, i kulturës e i gjenezës së trevës sonë. Për të gjithë këtë kontribut madhor, Shoqata Atdhetare "Dukagjini" e ka nderuar me titujt: "Nderi i Shoqatës Dukagjini", "Mirënjohja Martin Camaj" dhe "Pishtar i Arsimit".

Në jetë e në punë, pranë Luigjit ka qenë gjithmonë e pranishme Gjystja, zonja e mirë e fisit të njohur prej Lotajve të Shalës, bashkëshortja, kolegia, mësuesja e përkushtuar, që për 42 vjet punë në arsim ishte forca e heshtur që e mbështeti fort me dashuri e përkushtim në çdo hap të jetës. Së bashku rritën pesë fëmijë të mirë, të arsimuar e të ndershëm që sot gëzohen me tetë nipa e mbesa, të cilët mbajnë në damarë gjakun e prindërve të tyre. Ata kanë mbyllur sot një vit shumë të vështirë, vitin më të rëndë të jetës, por krahas dhimbjes për humbjen e madhe do të vazhdojnë të jenë gjithmonë krenarë për babain e tyre.

Ata që e kanë njohur Luigjin e dinë mirë se ai ishte njeri i urtë, i butë në fjalë, por i palëkundur në parime, një njeri që punonte shumë e që kërkonte nga vetja më shumë se nga të tjerët. Një njeri që besonte se dija dhe dashuria për vendin janë pasuria më e madhe. Sot, në këtë përvjetor përkujtimor, ne nuk flasim për një njeri që s'është më, por për një vepër të gjallë. "Le të vdesë jeta" e një njeriu, dhe kjo një ditë do të ndodhë patjetër, por "të mos rrojë pafundësisht vdekja"! Dhe Luigj Shyti vazhdon të jetojë në librat e tij, në gazetën "Dukagjini", te nxënësit që edukoi, në fjalën e urtë që la pas, në çdo kujtim të mirë që ngroh shpirtin e njerëzve të tij. Ai do të mbetet përherë pishtar i arsimit dhe kulturës, një bir i denjë i Dukagjinit, një njeri që i dha shumë vendit të vet, duke mos kërkuar asgjë të tepërt për veten.

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!

Nderim e lavdi të përjetshme jetës, punës dhe veprës së Luigj Gjergj Shytit!

Të rrojnë e ta kujtojnë familja e të afërmit, shokët dhe miqtë e tij të dashur, i gjithë populli i Dukagjinit!

Prof. Dr. Vuksan Kola
Shkodër, 20.10.2025

ROMANI "BLERTA" E SHKRIMTARITI LUIGJ SHYTI

Prele Shytani

Luigj Shyti ka një vit që na mungon fizikisht , por puna e madhe që bëri si: mësimdhënës, drejtues i zoti, krijues si poet, studiues, publicist, eseist e gazetar si dhe emri i mirë që la pas siguroj pavdekësinë, duke jetuar në zemrat e të gjithë atyre që e njohën. Ai lëvroj shumë gjini letrare, paralel me mësuesinë dhe vitet e fundit të jetës i hyri me shumë sukses edhe romanit, duke qenë ndër krijuesit e rrallë dukagjinas që kanë shkruar në këtë gjini.

U paraqit para lexuesve si shkrimtar me romanin "Blerta", për të cilin po i them opinionin tim.

Romani ka si objekt dashurinë e dy të rinjve, Martinit e Blertës të lindur, rritur e shkolluar në Dukagjin. Tema është interesante e problemore, normat bashkëkohore mbi bazën e ndjenjave të dashurisë dhe mirëkuptimit për martesën e konsolidimin e familjes.

Personazhet e romanit si mësues, edukator e veprimtar shoqëror ishin shumë të emancipuar, të cilët në çdo hap bënin luftë të papajtueshme ndaj paditurisë e injorancës, traditat konservatore e patriarkale, sidomos në drejtim të formimit të familjes e lidhjeve martesore, duke ju dhënë një mentalitet të ri. Këtë shembull na e japin me shumë zgjuarsi e këmbëngulje Martini e sidomos Blerta, ku mentaliteti mesjetar për dashurinë e martesën mbizotëronin në Dukagjin.

Shkrimtari, krahas ngjarjeve episodike e të papriturave që shoqëronin gjatë gjithë kohës jetën e dy të rinjve, në roman me shumë mjeshtëri na jep peizazhe të bukura e interesante të fshatit, krahinës e zonës, shkollat ku jepnin mësim, veprimtaritë e ndryshme ekonomike, shoqërore e argëtuese me qëllim futjen e normave të reja në mënyrën e jetesës e formimin e familjes, ku Martini e Blerta ishin pjesëmarrës të përhershëm e shumë aktiv. Në të gjitha ato veprimtari, "rastësia "apo pak edhe kujdesi i gjente afër njëri – tjetrit, Martinin e Blertën. Në këtë mjedis u dashuruan dy të rinjtë. Dy të rinjtë, të etur për dije u shkolluan shumë shpejt dhe u bënë model i të ardhmes emancipuese. Nuk ishte e lehtë që normat dhe traditat shekullore të transformohen aq shpejt.

Me guxim e kuraja Blerta e mori në dorë vetë fatin e së ardhmes së saj. Ajo nuk e individualizonte plotësisht problemin për djalin që donte. Sipas saj gjithçka do të bëhej në harmoni me pëlqimin e prindërve të saj -Nikës e Palinës, me të cilët kishte një lidhje të veçantë e respekt të ndërsjellët .Por ajo ju thoshte se, nuk martohem pa pëlqimin e tyre, por edhe se nuk marr djalë tjetër përveç Martinit, me gjithë kërkesat e shumta që kishte.

Krah dy të rinjve ju bënë axha i Blertës, Marketa dhe shoku i femërisë së Martinit, Antoni. Në lidhjen e tyre u bënë pengesë opinioni i sëmurë, individ të veçantë si operativi Tahiri e sekretari i partisë, të cilët kishin qëllimet e tyre ndaj Blertës, e deri te letrat anonime, por falë vendosmërisë së tyre të gjitha pengesat u përballuan me sukses dhe lidhja e tyre u kurorëzua e u konsolidua në marrëveshje edhe midis familjeve të tyre emërmëdha të krahinës, Nikë Shalës e Prelë Bjeshkës, duke e ligjëruar lidhjen e tyre.

Tani çifti i ri ishte i gatshëm për martesë e konsolidimin e familjes.

Normat e reja që koha i kërkonte u manifestuan edhe gjatë dasmës, ku ndër të parët çifti përdori fustanin e nusërisë, dhëndri krushk apo organizimi shumë i qytetëruar i dasmës.

Lidhja e tyre u fuqizua nga viti në vit, duke mos pas krisjen më të vogël, duke dhënë edhe frutat e saj, me pesë fëmijë të mrekullueshëm, ku arritën me pa edhe dasmat e pasardhësve që paraqiten aq realisht në mbyllje të librit.

Në libër përshkruhet me shumë realizëm e dhimbje ana shëndetësore e Martinit vitet e fundit, optimizmi dhe kurajoja e tij për ta mposhtur sëmundjen dhe kujdesi në shkallën sipërore të familjes së tij, të djemve ku njeri studionte për mjekësi e në mënyrë të veçantë i bashkëshortes Blerta, e cila ju gjend gjithmonë pranë.

Romani "Blerta" është një roman autobiografik ku autori ia dedikon shoqes së jetës Gjystes, që në roman quhet Blerta, sepse pa prezencën, përkushtimin dhe ndihmesën e saj nuk do ta kishte tërë atë veprimtari e fjalë të mira, nuk do ta kishte aq të konsoliduar atë familje shembullore me pesë pasardhës, të cilët si shëmbëlltyrë e prindërve tani vazhdojnë jetën e tyre të pavarur e të suksesshme.

Ky roman i shtohet krijimtarisë letrare të dukagjinasve, i cili ja vlen për t'u lexuar e pasuruar bibliotekat personale.

Romanin në fjalë e lexova me një frymë, sepse duke pas një njohje të plotë me Luigjin e Gjysten, që në rininë e tyre, duke pas miq e shokë të përbashkët e lidhje të shumëfishta, njoha personalisht të gjithë personazhet e librit, me emrat e tyre real, mjediset ku vihen ngjarjet dhe mbeta i mallëngjyer.

Prandaj ju këshilloj që ta lexoni këtë libër, sepse do të mbeteni shumë të këna qur.

Lavdi jetës dhe veprës së LUIGJ SHYTIT !

VRASJET TONA "DEMOKRATIKE"

Kolegu e miku im i vjetër, Musa Kurtllaj, dje zbuloi me trishtim nji shifër lufte të vrasjeve në Shqipninë postkomuniste. Statistikë e konfirmueme nga arkivat e Ministrisë së Brendshme, e publikue në media prej gazetarit Roland Qafoku.

Tmerr: 6652 vrasje "demokratike" prej vitit 1990 deri më 2025, që i bije një mesatare prej 190 trupash që i merri plumbi çdo vit.

Ja pra, "vrasjet tona demokratike" tridhjetëvjeçare ua kalokan vrasjeve politike "komuniste" pesëdhjetëvjeçare me 1952 krena.

O Zot, ku je?!

O Zot, a sheh a je verbue?!

O Zot, a ndigjon a je shurdhue?!

Kjo asht fytyra e "demokracisë sonë të përbaltun"!

Kjo asht fytyra e përgjakun e kthimit në identitetin tonë primitiv, mesjetar, ku armiku ma i madh i shqiptarit mbet vetë shqiptari, vetë vllau me vllanë, komshiu me komshiun, fisi me fisin.

E për çka bre?

- Për nji fjalë goje, për nji pëllëmbë tokë, për nji vijë uji, për nji dhomë, për nji wc, për nji bulshi bukë, për nji parcelë kanabisi, për nji kerr kontrabande, për nji gjurmë dhie, seks e marrëzi pa fund! Me thanë të drejtën e hakun: jemi popull i vështirë, i sertë si xehri; jemi ujk që kemi kafshue veten.

Në planin e madh të historisë, jemi nji popull i përhumbun nën zgjedhat mijëvjeçare të perandorive botnore, kacagjela që e kemi përgjakë njeni-tjetrin qysh prej ilirëve e deri më sot.

Udhëtimi ynë në histori asht tragjikisht i dhimbshëm!

Ku ishim bre, qysh prej Gentit e deri në mesjetën e Gjergjit tonë?

Mjaft mburremi në rrjete sociale si pellazgë, ilirë e arbërorë!

Po mbas shuarjes nga ethet të lavdiplotit, çka na mbeti?!

- Terr, letragji e tmerr!

Luftuam me heroizma të pa shoq për të huajt, por për vete s'ditëm me luftue as me punue; përkundrazi, mbetëm tue vra më shoqi shoqin me efsh të pa fre.

Misionari e kleriku italian Alberto Karaçi, që erdhi në Shqipni më 1888, pa, dëgjoi e shkruejti për shqiptarët. Gjaja ma fatale që e tronditi, ishte hakmarrja e urrejtja që mbartnin këta "fëmijë tekanjozë e të armatosun" të Evropës.

Ai shkroi:

"*Unë besoj se ata kurrë nuk e kanë ditë çka asht kënaqësia e vërtetë e paqes shoqnore; janë lindë, mund të thuhet, midis zhurmës së të shtënave e derdhjes së gjakut njerëzor, me prirje tradicionale për me pasë zili e me urrye njeni-tjetrin. Nuk kalon javë pa ndigjue ndonjë ngjarje tragjike; nuk kalon vit pa ndonji shtëpi të djegun e jetën e rrënueme*".

Edhe sot?

Jetojmë në nji shoqni ku koka e njeriut kushton ma pak se nji shalqini

Në nji shoqni ku njerëzit u vetearmatosen, tue shkatërrua ushtrinë kombëtarë dhe pushkët ia drejtuan vetes. Ishim mërzitë shumë në diktarurë pa heroizma gjakmarrje.

Në nji shoqni ku rinia ikën si tufë zogjsh pa kthim; ku korrupsioni, droga, trafiqet, bixhozi e kurvnia janë "trend". Në nji shoqni ku familja rrënohet përditë, aty "kapitalizmi demokratik" lulëzon si kolos i pamposhtun, mes demagogjisë, gjakut, pisllëkut e retorikës për "liri", "pluralizëm" e "drejtësi universale".

Po besa po barazi mes ujqve e deleve pa çoban!

Shpresa nuk vritet asnjëherë!

Por ndoshta ende s' asht vonë.

Në fund të këtij deti gjaku u pa ndoshta nji pikë drite, që po rri e fjetun, diku ndër shpella të shpirtit tonë. Ajo dritë asht pendesa, e lind prej ndërgjegjes, jo prej frikës. Ajo dritë asht besa, urtia e të parëve, e nëse e mbjellim prape në zemër, ka me dalë si dritë e re prej errësinës.

Le t'i kthejmë pushkët në vegla pune, fjalët në urtësi, zemrat në vend të burrnisë, se shqiptar nuk bahemi tue vra, por tue ndërtue, tue dashtë e tue mbajtë nderin gjallë.

E nëse sot e ndalim nji zemërim, nji gjakmarrje, nji urrejtje, kemi shpëtue nji jetë, kemi shpëtue vetveten. E Zoti, që duket se hesht, ndoshta po pret me pa nëse dimë me u ba njerëz, para se të jemi "demokratë", "socialist" , "liberal" apo "radikal"

Atëherë, ndoshta, Shqipnia s'ka me kenë ma tokë vrasjesh, por dhe e pajtimit, ku fjala e burrit vlen ma shume se plumbi.

***Prelë Milani**

FYTYRA E SHOSHIT NË EKRAN

(ESE PËRKUJTUESE PËR GJON VATËN KARAKTERIOALIN GJURMËLËNËS)

Në Shosh, aty ku mali i prek retë e qiellit dhe uji rrjedh prej gurit si tingull i vjetër i një kënge pa autor, bash në kërthizën ma fotozhnike të kësaj treve gjendet një tokë e sheshtë, e rrethueme me gështenja të nalta, që rrinë roje si ushtarë të heshtun. Kjo asht ara shpatullgjanë e Hil Mirashit, një copë dhe që s'u tremb kurrë prej dimnit, prej furtunës, prej kohës. Aty brenda rrjedh trung i Vllaznisë së Ndreashajve, i atlashit Ozman Hysa i Pep Sumës trung që nuk u tha, nuk u shit, as nuk u pre asnjëherë .Prej këtij trungu doli Gjon Vatë Mirashi, që pa le në Shkodër, në vitin 1912, por zemra e tij mbeti gjithmonë në mal.

Ai ishte prej atyne burrave, që lindin me shtat të drejtë dhe shpirt të randë, si lisat e ashtës. Me supet e gjana e shtatin fortë, ai dukej sikur mbante mbas vetit kujtesën e një fisi të tanë. U rrit ndër sokakë të Shkodrës, tue pa qytetin me sytë e një njeriu, që as një herë se harroi kah vjen.

U ba mjeshtër i hekurit e i motorit; duart e tij, të kalitura në punë, mbajnë edhe sot në kujtesë zhurmën e punishtes, ngrohtësinë e vajit, trokun e mjetit të drejtë. Por ai nuk ishte vetëm mjeshtër i zanatit: ishte burrë i librit, i mendimit dhe i kuvendit të urtë. Gotën e ngrinte për gëzim, jo për harresë; nuk kishte njeri që s'i rrinte mirë pranë.

Në kohën e trazimeve, ai nuk zgjodhi heshtjen e frikës, por ecjen e burrit: u rreshtua me antifashistët, krah me Prof. Kolë Prelën, Bal Markun, Gjelosh Lushin, Ndue Sokolin e Gjon Marashin. Nuk kërkoi lavdi as shpërblim se besa nuk bëhet për pagesë.

Në Parkun e Mallrave punoi më shumë se dy dekada. Estrada amatore e qytetit të Shkodrës e pati si shtyllë; aty qeshi, këndoi, u gjallnue, dhe i dha frymë. Teatri "Migjeni" e thirri jo pse ishte aktor i shkolluem, por pse ishte njeri me pamje, tërhijekse me timbër dhe hijeshi të natyrshme, atë lloj burrit që kur shfaqet në skenë, je i detyruem me e ndjekë me sy.

Në filma ai nuk luajti për me mbete në histori. Por historia e mori vetë:

në "Lindje në stuhí",

në "Ditët që sollën pranverë",

në "Shembja e idhujve",

e në dramat "Shota" e "Baca i Gjetjeve",



Ai nuk pat rolin e madh, por pat fuqinë e pashlyeshme të portretit, që nuk imitohet. Ai nuk dinte me qenë dikush tjetër, ai gjithmonë ishte Gjon Vata. Burrë i heshtun, i drejtë, i qetë, i rreptë kur duhej dhe i butë kur kish vend me u ba i butë.

Kuvendar i urtë, mikpritës i lindun, gëzues i jetës pa tepri.

Pata fat ta njihja e bisedoja me të, pasi ishte mik i vjetër i gjyshit tim Bal Mark, nga i cili pata shumë dhuratë të tilla.

Gjon Vata ishte burrë zemër gjanë sa ara Hilës, që e rriti. Vdiq në vitin 1986, larg zhurmave, larg llafeve që vijnë e shkojnë. S'u bë përmendore. S'u ngrit bust. Por nuk pati nevojë. Sepse ka burra që nuk i ruan bronci, i ruan kujtesa. Ka burra që nuk i laton dora e skulptorit, por dora e kohës. Ka burra që nuk i vendos historia ndër libra, por ndër zemra.

Gjon Vata asht një ndër ta. Ai rrinë ende aty, në hijen e lisit që s'u shkurtue, në tokën atnorë më fytyrën që na sheh prej filmit, me zanin që na thërret me u mbajt drejt. Shikoni portretin e tij prototip i fytyrës së shoshianit të moçëm të skalitun si monomet natyror antropologjik.

Kush se njeh, ja ky asht Gjon Vata, fytyra e Shoshit ne ekran.

Një falënderim te veçantë artisteve te mirënjohur, Astrit Fani e Drande Xhaj, për arkifaktet që më afruan.

Prelë MILANI

Festë diplomatike e kulturës austriake në nder të Ditës Kombëtare të Austrisë

Më 30 tetor 2025, në qytetin e Shkodrës u zhvillua ceremonia zyrtare me rastin e Ditës Kombëtare të Austrisë dhe hapjes së Javës Kulturore Austriake 2025, një traditë e përvitshme që simbolizon miqësinë e qëndrueshme ndërmjet Austrisë dhe Shqipërisë.

Ngjarja u organizua nga Konsullata e Nderit e Austrisë në Shkodër, nën kujdesin e z. Gjergj Leqejza, dhe u nderua me praninë e Ambasadores së Austrisë në Tiranë, Sh. S. znj. Monika Zach, si dhe të përfaqësuesve diplomatikë, autoriteteve vendore, komuniteteve fetare, personaliteteve të kulturës dhe qytetarëve shkodranë.

Atmosfera festive u pasurua nga performancat tradicionale të nxënësve të Shkollës Austriake "Peter Mahringer", të cilët edhe këtë vit sollën me profesionalizëm dhe emocion një program të veçantë artistik, duke dëshmuar lidhjen e fortë arsimore dhe kulturore mes dy vendeve.

Pika kulmore e mbrëmjes ishte performanca muzikore në kuadër të Javës Kulturore Austriake, me koncertin e Clara Montocchio Quintet "Strauss takon Jazz-in", dedikuar 200-vjetorit të lindjes së Johann Strauss II. Një interpretim i veçantë që bashkoi elegancën klasike austriake me ritmet bashkëkohore të jazz-it, duke krijuar një përvojë artistike unike për publikun dhe duke simbolizuar ndërthurjen e traditës me frymën moderne të kulturës austriake.

Këtë vit, ceremonia u mbajt për herë të parë në Hotel "Çikago", një vend me standard klasi dhe hijeshi, që i dha veprimtarisë një frymë të re dhe dinjitoze. Hoteli menaxhohet nga një sipërmarrës i ri dhe i suksesshëm, z. Genc Çardaku, bir i një familjeje me prejardhje dukagjinase dhe djali i nënkryetarit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", z. Kolë Çardaku, duke e bërë këtë bashkëpunim edhe një shembull të angazhimit të brezit të ri të biznesit vendor në mbështetje të zhvillimit kulturor të qytetit.

Në përfundim të mbrëmjes, Konsulli i Nderit i Austrisë në Shkodër, z. Gjergj Leqejza, theksoi në fjalën e tij se marrëdhëniet mes Austrisë dhe Shqipërisë mbeten një shembull i miqësisë së qëndrueshme, që buron nga histori e përbashkët dhe bashkëpunim i vazhdueshëm në fusha si arsimi, kultura dhe zhvillimi ekonomik. Ai vlerësoi rolin historik të Austrisë në mbështetje të pavarësisë dhe rrugëtimit evropian të Shqipërisë, duke nënvizuar se lidhjet e ndërtuara ndër shekuj – nga Shkolla "Peter Mahringer" te bashkëpunimet akademike e ekonomike – përbëjnë themele të forta për të ardhmen.

Në fjalën e tij, konsulli shprehu mirënjohje për të gjithë të pranishmit dhe për qytetin e Shkodrës dhe gjithë Veriun e Shqipërisë që mbeten qendër e gjallë e miqësisë shqiptaro-austriake, duke e mbyllur mbrëmjen me një mesazh të thjeshtë, por domethënës: mirënjohje, respekt dhe miqësi që vazhdon.

***

FJALA E KONSULLIT TË NDERIT TË REPUBLIKËS SË AUSTRISË, NË SHKODËR, Z. GJERGJ LEQEJZA!

Të nderuar përfaqësues të komuniteteve fetare,

Të nderuar drejtues të pushtetit vendor,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Shqipërisë,

Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të trupit diplomatik,

I/E nderuar ……,

E nderuar Ambasadore e Republikës së Austrisë, znj. Zach,

Të nderuar miq,

Pas festimit si gjithnjë të bukur e dinjitoz në Tiranë, jemi sonte këtu për të festuar së bashku Festen Kombëtare të Austrisë, të popullit mik austriak – simbol i kulturës, mirëqenies dhe paqes në Evropë e më gjerë – festë që padyshim bëhet edhe më e bukur me praninë tuaj si çdo herë. Një faleminderit me zemër!

Austro-Hungaria e asaj kohe dhe Austria e sotme kanë qenë të pranishme në veriun e Shqipërisë, me qendër në Shkodër, që nga fillimet e shekullit XVII. Jam krenar që përfaqësoj një komb me kaq shumë dimensione kulture, zhvillimi dhe humanizmi, dhe po aq krenar që lidhjet mes kombeve tona po forcohen ditaditës.

Austro-Hungaria dhe Austria e sotme janë miqtë më të sinqertë dhe më të vlefshëm historikë të kombit shqiptar, të cilët, jo rastësisht, kanë pasur një rol shumë të rëndësishëm – e shpeshherë vendimtar – në momentet ku është përcaktuar fati politik dhe historik i vendit tonë. Edhe sot, siç theksoi znj. Ambasadore mbrëmë, Austria dhe drejtuesit e saj kanë qenë dhe mbeten mbështetës e garantë të rrugës pa kthim të Shqipërisë drejt familjes evropiane.

Austria është një kontribuuese e rëndësishme në jetën ekonomike, kulturore dhe arsimore të vendit tonë, veçanërisht në veriun e Shqipërisë.

Nga Shkolla "Peter Mahringer" dhe bashkëpunimi me Universitetin "Luigj Gurakuqi", te prania e institucioneve financiare si Raiffeisen Bank, Uniqa Group dhe Vienna Insurance Group, deri te projektet energjetike të Ashtës dhe ato të ujësjellësve, Austria ka dhënë një kontribut të qëndrueshëm në zhvillimin e vendit. Sot i kemi këtu për të festuar së bashku këtë miqësi dhe bashkëpunim të vyer, ndërsa nxënësit e Shkollës Austriake, si gjithmonë, do të na bashkohen duke paraqitur talentin e tyre artistik me këngë dhe valle austriake.

Sivjet, në bashkëpunim me iniciativën e Javëve Kulturore Ndërkombëtare, gjatë Javës së Austrisë, në Shkodër do të kemi kënaqësinë të mirëpresim grupin e njohur austriak Clara Montocchio Quintet, të cilët do të sjellin Strauss-in në dimensionin e jazz-it, për të na njohur edhe më shumë me dimensionet kulturore dhe shpirtërore të popullit austriak.

Një falënderim edhe për pronarin e këtij lokali të këndshëm për mundësinë që na dha për organizimin e kësaj pritjeje.

Por falënderimi kryesor shkon për ju — për praninë tuaj të përhershme.

Gëzuar Festën Kombëtare të Austrisë!

Faleminderit!

Jona LEQEJZA

NJË LIBËR QË MË DUKEJ SI "TRËNDAFIL NË STUHI"

Mirëserdhët ju e nderuara artiste dhe shumëdimensionale, znj. Xhuljeta Ferraj!

Është një shprehje që thotë: "Me kenë Shkodran, të tana i ban", por edhe poetja në fjalë më duket si me kenë Shkodrane. Sepse, përveç paraqitjes që duket, ajo është një poete, që ka shkruar në gjininë e poezisë, romanit dhe dramës; është këngëtare, valltare, aktore dhe koreografe. Ka studiuar për informatikë, për estetikë dhe në një akademi ndërkombëtare aktrimi.

Por më e veçanta, është një zonjë e fortë, luftëtare e pa kompromis në mbrojtjen e të drejtave të gruas.

Shpesh debatohet nëse talenti është dhunti apo punë, dhe unë mendoj se artisti apo artistja lind, pastaj puna dhe fati përcaktojnë shkallën e karrierës apo të suksesit të secilit.

Të gjithë ata që luten, kanë dëshirë që lutja e tyre ndaj Zotit të përcillet nga një vend i shenjtë.

Të gjithë poetët kanë dëshirë, që librat e tyre, krijimet e tyre, t'i promovojnë në ambiente të njohura kulturore e artistike. Prandaj mendoj se kjo ka qenë arsyej,a që znj. Xhuljeta Ferraj ka zgjedhur pikërisht Shkodrën, djepin e artit dhe të kulturës, për të promovuar librin e saj me poezi "E vuajtur por jo e harruar".

Të vish nga Vlora, ku poetja ka lindur, apo nga Italia ku jeton, për promovimin e librit në Shkodër, këtë sakrificë e bën vetëm pasioni.

Mirëserdhët në Shkodër, artiste e nderuar!

* Unë zakonisht në promovime nuk flas gjatë; jap këndvështrimin tim për librin, citoj ato gjëra që më pëlqejnë si lexues dhe si krijues.

Ndodh ndonjëherë që, kur s'kam çka flas për librin, komentoj autorin… ose e kundërta.

Në fakt, poeten e nderuar e njoh vetëm nga rrjetet sociale, dhe librin e kam marrë e lexuar prej disa kohësh.

Prandaj kam njohuri dhe opinion të plotë për të folur gjatë, për librin dhe për poeten, por do të respektoj kohën

* Së pari, urime dhe komplimente për këtë libër, që sipas syrit tim ka nivel artistik dhe mesazh njerëzor.

Është një tip poezie që të jep relaksim, leksion dhe frymëzim.

Nëse do të duhej të prek diçka në këtë libër do të ishte titulli:

Unë do ta kisha titulluar "Trëndafil në stuhi", sepse tematika e librit, por edhe shumica e krijimtarisë së Xhuljetës, është e ngjashme me një Trëndafil, që mbetet i bukur në të gjitha stinët e vitit dhe në të gjitha stuhitë e jetës.

* Mendoj, se artisti apo edhe poeti e ka të pamundur të ndaj botën e tij të brendshme nga krijimtaria, apo të shkëpusë frymëzimin nga realiteti. Prandaj edhe këto poezi, që sot na vijnë në këtë libër janë produkt i përjetimeve të autores.

Po citoj dy vargje:

"Të gjithë më deshën me fjalë,
duke ma goditur zemrën me grushta."

Kjo është bota sot – dashuri sipërfaqësore.

Xhuljeta është e ashpër kundër fenomeneve negative të kohës, por e bute ndaj ndjenjave njerëzore , melankolike para botës femërore.

Në vargun e saj duket natyrë krenare dhe triumfatore; rrallë sheh brishtësi tek vargu i saj, duket se sa herë rrëzohet, ngrihet më e fuqishme.

"Më mirë një tigër, një luan që më sheh egër,

se sa këto qenushët e vegjël që më servilosen."

Nëse e zbërthejmë apo e analizojmë këto dy vargje, thotë dhe nënkupton shumë. Është pak e ashpër me botën, gjininë tjetër, por ka edhe shumë finese metaforike brenda.

* Aty ka poezi lirike, epike, tematika kurbeti , dedikime, poezi meditative dhe filozofike, por unë do të veçoj njërën prej tyre:

"Gjumin ta prish hasmi,
qetësinë ta prish pasuria.
Le të jem gjithmonë e varfër,
aty ku mbizotëron dashuria."

Një filozofi poetike, që ka thellësi mendimi, nota artistike dhe spiranca shprese. Secili ta shijoj me stilin e vet, por ky është shpirti i çdo poeti dhe poete.

* Në libër ka shumë vargje lirike. Në fakt desha të zgjedh disa, sepse disa më lanë mbresa dhe më mbetën në kujtesë, por ndërrova mendje.

Ju ftoj ta lexoni dhe ta shikoni poezinë me titull "Xhuljeta".

Besoj se, aty ka lirika dhe metafora sa të duash; edhe si strukturë nuk duket keq, përkundrazi, është shumë bukur.

Prandaj një poezi lirike më të bukur se autorja e librit nuk kisha ku ta gjej!

* Me fjalën e opinionin tim, besoj se kam nxitur kureshtjen tuaj për ta lexuar librin dhe poeten Xhuljeta Ferraj.

Uroj që të mbetet e kënaqur në ëndrrën e saj, për të promovuar krijimtarinë në Shkodër, mes këtij auditori kaq special dhe artdashës.

* Do ta mbyll fjalën time me dy vargje emblematike, të shkëputura nga libri:

"Jeta është bardhë e zi,
vetëm për ata
që shpirtin e kanë pa ngjyra."

— No koment, sepse nëse e komentoj, nuk ndalem për shumë minuta

* Lexojeni këtë libër dhe gjithë krijimtarinë e poetes Xhuljeta Ferraj, sepse aty do të gjeni një ylber me ngjyra.

Suksese në misionin tuaj poete!

Suksese në rrugën e krijimtarisë dhe të artit, sepse jeni vërtet një shembull frymëzimi.

Urime dhe faleminderit !

Lulash Brigja nëntor 2025

KUR HESHTJA FLET

Vëllim poetik nga, Nikolin Sh. Lëmezhi

Vëllimi poetik titulluar, «Kur heshtja flet» e autorit Nikolin Sh. Lëmezhi është një udhëtim i ngarkuar me emocione filozofike, ku poezia, si një formë e fuqishme shprehëse, shqyrton thelbin e jetës dhe të natyrës njerëzore. Kjo vepër karakterizohet nga një gjuhë e pasur dhe e thjeshtë, ku del në pah mundësia e eksplorimit të jetës, me qëllim që të kuptojmë më shumë për veten dhe botën përmes asaj që kurrë nuk thuhet, pra, përmes heshtjes.

Titulli i veprës, nuk është vetëm një pasqyrë e një poezie të vetme, por është një manifest që thërret për një meditim të thellë mbi rolin që luan heshtja në jetën e çdo njeriu. Poezia është një reflektim mbi mundësinë e të kuptuarit të asaj që shpesh mbetet e papërshkruar me fjalë, me qëllim që të shohim përtej asaj që shfaqet dhe të ndiejmë jetën në përditshmërinë e saj, përmes gjithçkaje që mbetet e pashprehur.

Në mënyrë të veçantë poezia me të njëjtin titull si edhe e gjithë vepra, shërben si një pikënisje për të gjithë vëllimin. Ajo zë vend në faqen e 107-të të librit, dhe bën thirrje për të dëgjuar atë që shpesh na shpëton, për të kuptuar se thellësia dhe bukuria e jetës shpesh qëndrojnë në ato momente kur fjalët heshtin dhe shpirtit i jepet mundësia që të flasë përmes ndjenjave të pastra dhe mendimeve të thella, siç thuhet veçanërisht në vargun:

"Kur njerëzit heshtin e heshtja flet, aty ka jetë".

Ky vëllim poetik është një thirrje për të mos e humbur shpresën, për të kërkuar dritën edhe në momentet e errëta, dhe për të besuar në fuqinë e brendshme që e udhëheq njeriun drejt kuptimit më të lartë të vetvetes dhe të botës. Autori ka krijuar një elegji poetike që është e këndshme sa i takon formës artistike, por që është gjithashtu edhe një shtysë për të reflektuar mbi gjithsecilin që dëshiron të shqyrtojë më thellë shpirtin e tij dhe botën përreth.

Poezia e vëlla Nikolin Sh. Lëmezhit është një frymëzim për vetë thelbin e jetës dhe të asaj që është shpesh e padukshme, e cila mbetet një pasuri e vërtetë letrare dhe shpirtërore për çdo lexues.

Duke dashur që zëri i ëmbël i heshtjes dhe gjuha e saj, të jehojnë gjithnjë e më shumë për gjithë lexuesit dhe dashamirësit e poezisë, autori e ka botuar këtë vëllim poetik edhe në gegnishten dialektore në tetor të vitit 2023, (përshtatur nga z. Ndrekë Zalli), në anglisht në dhjetor të vitit 2023, (përkthyer nga znj. Laura Hamitaj) dhe në gjermanisht në maj të vitit 2024, (përkthyer nga znj. Klodjana Mark Murri).

Me shumë etje dhe dashuri e lexova edhe versionin e këtij vëllimi, të shkruar në gegnishten dialektore, çka edhe më bëri që ta admiroja veprën akoma më shumë.

Duke lexuar poezitë e vëlla Nikolinit, njeriu dashurohet me bukurinë e heshtjes dhe bëhet më i aftë për të hyrë brenda vetes, e për të gjetur kështu rrugën e bukur të dashurisë e të paqes së vërtetë.

Më në fund, njeriu mëson që të mos ketë frikë nga heshtja, por ta dojë atë, ta kërkojë, sepse duke gjetur heshtjen ai krijon edhe mundësinë për të gjetur vetveten. Duke gjetur vetveten, përmbush edhe aspiratat e tij më të thella për të qenë realisht i lumtur.

I urojmë më të mirat vëlla Nikolinit, dhe e falënderojmë me mirënjohje për këtë vepër të mrekullueshme letrare, duke shpresuar gjithashtu se do të kemi bekimin të lexojmë akoma më tepër vepra me vlerë prej tij në të ardhmen!

Adi HALITI, *Zvicër*

BURRË QË NUK MUND T'I MERREJ JETA PËR GJAK!

(Përkujtimore për burrin e Mërturit, inxhinierin dhe pedagogun e Pylltarisë shqiptare, Gegë Sokoli)

Kanë kaluar 34 vite që kur u shua në mënyrë tragjike jeta e Gegë Sokolit, intelektualit dhe inxhinierit të pyjeve nga Nikaj-Mërturi. Ai ishte njeri me dije, përkushtim dhe dashuri të thellë për natyrën dhe njerëzit. Me punën e tij ai kontribuoi si specialist, drejtues dhe mësimdhënës, në mbrojtjen dhe zhvillimin e pasurisë pyjore, duke u kujdesur që çdo dru pyjor e çdo shkurre të mbetej dëshmi e bukurisë së maleve tona.

Por Gegë Sokoli, mbetet simbol i njeriut të urtë, të ditur dhe të drejtë, që dashurinë për jetën dhe për natyrën e shndërroi në vepër.

Me datën 8 nëntor 2025, në një nga mjediset e "Hotel Tirana" u zhvillua një veprimtari madhështore në përkujtim të burrit të Mërturit, inxhinierit të pyjeve dhe mësimdhënësit Gegë Sokoli.

Nismëtar dhe realizues i kësaj veprimtarie ishte shkrimtari, intelektuali i njohur biri Nikajve, Pjetër Meta, me djemtë dhe familjarë, të afërm të inxhinierit Gegë Sokoli.

Në këtë takim, u shfaq një dokumentar mbi 45 minuta kushtuar jetës dhe veprimtarisë inxhinier Gegë Sokolit, me autorë Pjetër Meta e Ismail Buçpapa, u promovuan dy botime me autorë Pjetër Meta; "I pafajshmi"-roman dhe "Gegë Sokoli në kujtesën tonë", përmbledhje me kujtime dhe mbresa nga personalitete të ndryshme, që kanë njohur dhe bashkëpunuar me inxhinierin dhe pedagogun Gegë Sokolin në vite.

Në këtë takim përkujtimor, morën pjesë: personalitete të larta të shkencës dhe kulturës nga Tropoja dhe Tirana, deputet, banorë të zonës së Nikaj-Merturit, të Dukagjinit, nga Shkodra, Lezha, Mirdita, Durrësi, Vlora, e të tjerë, të afërm e familjarët e inxhinier Gegës të ardhur posaçërisht nga SHBA.

Në këtë takim, nga librat e promovuar, dokumentari që u shfaq dhe gjithçka u tha nga folësit e shumët mund të përmblidhen:

Inxhinier Gegë Sokoli, ishte një ndër intelektualët më të shquar të Nikaj-Merturit, Malësisë së Gjakovës, një personalitet i rëndësishëm i pylltarisë dhe shkollmiit pyjor shqiptar. Kudo ku punoj dhe drejtoj u dallua për logjike të shëndoshë, bashkëpunues dhe me urtësi. Ishte fisnik, human, i thjeshtë e donte shumë vendlindjen dhe njerëzit e saj. Ishte një familjarë shembullor, me bashkëshorten Marien rriti katër djem të kulturuar dhe shkolluar, të aftë profesionalisht, për të ndërtuar një jetë të suksesshme në USA. Për të gjitha këto cilësi para dhe pas vdekjes Gegë Sokoli, është nderuar me shumë mirënjohje dhe dekorata nga institucione dhe organizata të ndryshme.

Inxhinier Gegë Sokolit, në asnjë rrethanë dhe për asnjë motiv nuk duhej ti ndërpritej jeta në kulmin e veprimtarisë së tij. Ai ishte moshën më të mirë për të kontribuar për familjen, profesionin dhe shoqërinë në tërësi. Në "Malësitë tona" ka pas një shprehje në vlerësim të njeriut shumë të mirë, që thoshte: "Nuk vritet për gjak" (pra kur mashkull ishte shumë i mirë dhe me shumë vlera jo vetëm për veti por gjithë krahinën), kjo shprehje shkonte fiks për Gegë Sokolin, djalin e Brisës Merturit.

Gega gjithmonë është konsideruar i

pafajshëm, së pari nga At Zef Pëllumbi, kur shërbente prift në Shosh e u mor drejtpërdrejt me pajtimin e atij gjaku pikërisht për të mbrojte Gegë Sokolin, që kur ai ishte fëmijë. Ai në botimet e tij, ka shkruar pikërisht për këtë pajtim gjaku. Për pafajësinë e Gegës, është thënë në shumë shkrime të mëparshme nga shkrues të ndryshëm nga Nikaj - Merturi dhe jo vetëm, por tashmë në mënyrë më të plotë dhe në librin roman "I pafajshmi" me autor Pjeter Meta.

Në takim nga gjithë folësit u shpreh mirënjohje, respekt dhe vlerësim për gjithë atë që ka bërë z. Pjetër Meta, për organizimin e takimit përkujtimor dhe botimet, për katër djemtë e Gegë Sokolit (Alfredi, Edmondi, Floriani dhe Ervini) si dhe motrën e e Gegës, që dikush e quajti "Mbretëresha e ditës", File Sokol Lajthia (94 vjeçare), që mundësuan një kuvendim të madh të përbashkët në kryeqytetin e shqiptarëve. Nga ky takim disi i veçantë u dhanë shumë mesazhe nga të gjithë folësit, djemtë e Gegës dhe zonja File Sokoli. Jemi në kohë të tjera, hakmarrja, nuk duhet të ekzistojë si mendësi aq më pak si veprim çnjerëzore me shumë pasoja. Njerëzit duhet t'i thërrasin mendjes, larg vetëgjyqësisë, të jenë gjakftohtë e me logjikë të kthjellët. NJË JETË TA JEP ZOTI DHE VETËM AI MUND TA MARRË!

Kush ishte dhe ku punoi Gegë Sokoli?

Ai lindi në fashitin Brisë të Merturit, me 11 mars viti 1939. Ishte një vëlla me dy motra. Një muaj pas lindjes, Gegës i vritet babai, Sokol Zenuni, në tentative për tu arratisë nga burgu i Shkodrës. Është një kalavare vuajtjesh për Gegën me motrat dhe nënën e tij, mbetja jetim në Brisë.

Në vitin 1947, Gega në moshën 8 vjeçare vendoset në konviktin e sapo hapur fshatin në Xhan të krahinës së Pultit, në Dukagjin, ku fillon dhe shkollën fillore, pas një viti transferohet në fshatin Theth.

Në vitin 1949 transferohet në konviktin "Tom Kola" në Shkodër. Atje mbaroi arsimin 7 vjeçar dhe atë të mesëm në "Gjimnazin 29 Nëntori". Është një periudhë kur fillon të spikasë karakteri dhe cilësitë e tij të mira, të përshkruara ato nga bashkëkohësit në Shtëpinë e Fëmijëve në Shkodër.

Në vitin 1960, falë rezultateve të mira, i jepet një bursë studimi jashtë shtetit, në Fakultetin e Pyjeve në Brashovë të Rumanisë. Ai kthehet në Shqipëri në vitin 1961, pas një viti studimesh pasi u prishën marrëdhëniet me shtetin rumun. Ai vazhdon studimet në Fakultetin e Pyjeve në Tiranë, ndërkohë punon dhe si laborant në atë fakultet, diplomohet inxhinier pyjesh në vitin 1965. Ai në këtë periudhë kishte krijuar familjen, u martua me Marien, një vajzë nga Shkodra. Po në vitin 1965, ai emërohet dhe fillon punë në Ndërmarrjen Pyjore Fushë-Arrëz, Pukë.

Në vitin 1968, transferohet në detyrën e kryeinxhinier në Sharrat e Shemërisë të rrethit të Kukësit.

Në vitin 1970 emërohet drejtor në Ndërmarrjen Pyjore Tropojë.

Në janar 1977 për 8 muaj emërohet, në detyrën e drejtorit të Ndërmarrjes shfrytëzimit të pyjeve, në rrethin e Tropojës dhe në korrik 1977, ai merr emërim në detyrën e pedagogut, në Fakultetin e Pyjeve Tiranë.

Ai punon në ketë detyre,pedagog i dy lëndëve: "Dendrologji" dhe "Prodhime të dyta pyjore", deri në vitin 1987, kur transferohet në Ndërmarrjen e Kullotave Tiranë e sapokrijuar, në detyrën e përgjegjësit të Sektorit të personelit.

Në këtë detyrë vijoi punën deri sa u nda nga jeta. Nuk dihet pse u bë kjo lëvizje e Gegës me kthim përsëri në bazë.

Me 10 shtator 1991, shkon për të festuar tek nëna e tij në Brisë festen e "Zojës së Merturit", atij ju ndërpre jeta duke lënë pas një humbje dhe dhimbje të madhe në gjithë zonën e Nikaj-Merturit dhe jo vetëm. Në shkrimet ditar të asaj periudhe tashmë të publikuara nga Pjetër Meta, por dhe nga shkrues të tjerë, kjo ngjarje të ngjall emocione të mëdha deri në lotim dhe pikëllim të thellë dhe tani pse kanë kaluar 34 vite.

Në këtë shkrim u tha shkurt diçka për jetën dhe veprimtarinë e inxhinierit Gegë Sokoli.

Për jetën e veprën jetësore të Gegë Sokolit u bënë nderime e respekt të veçanta, si në asnjë rast tjetër:

* Bashkia Tropojë i dha titullin "MIRËNJOHJE E TROPOJËS";

* Shoqata Kombëtare e Specialistëve të Pyjeve i titullin titullin "MIRËNJOHJE";

Shoqata "BYTYQI" i dha titullin "KRENARI E MALËSIS SË GJAKOVËS"..

Me këtë rast, motrës së Tij, për qëndrimin e mbajtur në qetësimin e pajtimin e situatës brenda familjes e rrethit tyre familjarë, pas fundit jetësor tragjik e të pamerituar të Gegës, nga Urdhër Kombëtarë i Paqes ju dha titulli "AMBASADORE E PAQES".

Veprimtaria u mbyll me këngë e valle në nderim të jetës e veprimtarisë intelektuale e shoqërore të figurës së shquar të Gegë Sokolit. Pjetër Meta me bashkëpunëtorët ka bërë një punë të madhe e të lavdërueshëm me veprimtarinë që ka organizuar me një pjesëmarrje të gjerë.

Në botimet, dokumentarin dhe nga folësit atë ditë, është thënë shumëçka, por jo gjithçka për Gegë Sokolin pasi ai ishte dhe do kujtohet gjatë si personalitet shumë dimensional i Nikaj-Merturit dhe jo vetëm. "Përmasa" që bën Gegë Sokolin të paharrueshëm ishte ajo – Njerëzore!

Në fund të veprimtarisë familja e Tij (djemtë) për të pranishmit dhanë një koktej dhe shtruan një drekë, e cila do kujtohet e mbahet mend shumë gjatë.

Të pranishmit në fund të kësaj dite shumë mbresëlënëse u përcollën nga familjarët duke uruar: -NDERIM E KUJTIM I PAHARRUAR PËR JETËN E VEPRËN E GEGË SOKOLIT-; DHE SIÇ E KA TRADITË NË KRAHINA E NIKAJ-MËRTURIT "-HERË TJETËR JU ARDHSHIM NË GËZIME NË FAMILJEN TUAJ!".

Përgatiti: **GJON FIERZA**,
Ish student dhe kolegë i ***Gegë Sokolit***

Demokracia qytetare nuk bëhet, nëse mungon toleranca...

GËZIM TUSHI
"Mjeshtër i Madh",
"Kalores i Urdhrit te Skënderbeut"

Megjithëse kohët e fundit opinioni publik qytetar është sensibilizuar nga përballja me disa dukuri sociale shqetësuese, edhe pse nga politikanët, intelektualët, sociologët e psikologët është folur dhe shkruar shumë në median elektronike e atë të shkruar për situatën sociale të agravuar në Shqipëri, për nivelet e larta të dhunës, krimit, vrasjeve, neurotizmit social, sjelljeve të shëmtuara, dozave të forta të agresivitetit dhe mungesës së komunikimit qytetar, ende nuk janë të qarta deri në fund, që pse është kjo situatë kaq patologjike. Pse këto komunikime të vrazhdëta, veprime hakmarrëse, komportime antinormative?

Doemos është e natyrshme të pyesim: -Është e lidhur me të kaluarën tonë historike apo konceptimi ynë për tolerancën nuk është kultivuar në nivelin human dhe në standardet që kërkon qytetërimi modern? Sipas mendimit tonë, mungesa e tolerancës sociale dhe individuale e parë në shumë aspekte të thelbit dhe shfaqjes së tij, të duket që si konceptim nuk e ka fituar aq sa duhet statusin e përbërësit të kulturës qytetare. Madje për të qenë të sinqertë me të vërtetat e realitetit tonë, akoma ndeshemi me ngushtësi konceptuale, si produkt social i trashëguar i qytetërimit tonë. Është alarmante situata, në të cilin kufijtë e tolerancës sociale dhe individuale janë restriktuar në përmasa kritike. Është shqetësues mentaliteti social, i cili po shfaqet edhe në nënvlerësimin e rolit të tolerancës si instrument funksional për ndërtimin e shoqërisë së qytetëruar dhe formimin e qytetarit mendjehapur, i aftë për të kuptuar dhe pranuar marrëveshjen, marrëdhënien qytetare, hapësirën për "ekzistencën e tjetrit". Bashkë me të drejtën e tij dhe të kujtdo, që si qytetar të ketë të drejtën në çdo kohë për të "menduar ndryshe".

Zgjerimi i kufijve të tolerancës në shoqërinë tonë, konceptimi i gjerë i roleve dhe funksioneve sociale dhe individuale të qytetarëve tanë, në ndërtimin e shoqërisë normale dhe të diversifikuar, me marrëdhënie të ndërmjetësuara qytetare, është një nga problemet e mëdha të jetës sonë dhe sfida ndoshta më serioze e qytetërimit tone, spse toleranca në kohën e lirisë dhe demokracisë, në shoqërinë shqiptare akoma nuk është bërë parim social i përbashkët, mjet i veprimit universal të njeriut në shoqërinë qytetare e moderne që duam të ndërtojmë.

Kjo e vërtetë e njohur me kohë si tipar thelbësor i qytetërimit dhe marrëdhënieve qytetare, në shoqërinë tonë nuk është e përthithur në nivelin e duhur dhe në sasinë e kërkuar nga natyra e re e qytetërimit tonë. Nuk është momenti për të "zbuluar arsyet", sepse ato dihet dhe janë shumë. Me natyrë historike dhe etnike, kulturore dhe rajonale, të lidhura me konstitucionin tonë human, por dhe me peripecitë e deformimeve që ka marrë jeta dhe qytetërimi ynë. Qoftë nga faktorë historikë të jashtëm dhe të brendshëm, që kanë influencuar dhe ndikuar mbi të.

Nuk është e lehtë të ndërtohet dhe të vihet në funksion mekanizmi i tolerancës, në një shoqëri si jona që të paktën në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, komunizmi në mënyrë të përbindshme e denatyroi njeriun, e tjetërsoi në marrëdhëniet me të "tjerët", nëpërmjet dominimit të pikëpamjes tradicionale dhe ideve të ngurta monolite të njeriut për botën, shoqërinë dhe marrëdhëniet njerëzore. Besoj se klima sociale në shoqërinë tonë është bërë aq shumë konfliktuale, sa që e ka bërë të domosdoshme risjelljen në vëmendjen e opinionit publik të nevojës urgjente të luftës për përsosjen e instrumenteve humane, si rrugë për zgjidhjen e tyre të qytetëruar.

Praktikisht për shkaqe herë të kuptueshme nga ana sociale e herë me natyrë opake, ndonjëherë me shkaqe të justifikuara, e herë të tjera për arsye banale, në shoqërinë tonë është krijuar një klimë neurotike, e shoqëruar nga mungesa e theksuar e vendosjes në mënyrë paradoksale në të gjithë llojet e marrëdhënieve sociale në familje, komunitet dhe shoqëri duke u nisur nga mentaliteti i vendosjes së arsyes së forcës në vend të forcës së arsyes.

Shqetësim social në shoqërinë tonë është i drejtpërdrejtë, sepse në shumë aspekte, qytetërimi ynë po deformohet nga zgjidhja me dhunë e problemeve që kanë njerëzit. Madje, kjo e keqe është aq shumë e përhapur, sa që mund të flitet pa frikë për një proces të gjerë të "demokratizimit të dhunës", për një përhapje dhe zgjerim kapilar të saj në shoqëri, ambientet e jetës private dhe institucionet themelore të organizimit të jetës sociale në Shqipëri. Rëndësia e forcimit të ndjenjës së tolerancës qytetare në marrëdhëniet midis njerëzve, është shumë i rëndësishëm të evidentohet. Kjo sepse në fund të fundit, "Qytetërimi, para së gjithash, është vullneti për të jetuar në një bashkësi. Ndaj, një njeri është i paqytetëruar, barabar, në po atë masë që ai nuk i merr të tjerët në konsideratë. E kjo pasi barbarizmi është prirja ndaj çshoqërizimit". (Ortega Y Gasset, "Revolta e turmave", F.129).

Disa mendojnë se ndër shkaqet themelore të kësaj situatë është zgjerimi i lirisë dhe shtimi i frymës së individualizmit qytetar. Kjo sipas disa të tjerëve e ka burimin tek fakti që njeriu i mbyllur në vetvete, i dhënë tërësisht pas interesave të tij, ka filluar të bëjë monolog me veten dhe të mendojë vetëm për interesat e tij. Në këto kushte qytetari nuk është më fare i aftë që të bëjë dialog, të tregohet tolerant me të "tjerët", të gjejë rrugë të qytetëruara për zgjidhjen e konflikteve, por pa përdorur forcë dhe dhunë. Në shoqërinë shqiptare, në mënyrë paradoksale dhe tërësisht absurde, ka filluar të agravohet difekt social, siç është zbehja e mundësive të qytetarëve për t'i zgjidhur problemet, jo thjeshtë duke bërë monolog me veten, me forcë dhe vetëgjyqësi, por pa bërë të mundur procesin human të dialogimit si njeri, si qytetar, në marrëdhënie me të tjerët, duke gjetur zgjidhje që janë reciprokisht qytetare dhe të qytetëruara.

Por nuk duhet harruar për anjë çast që toleranca nuk është as vlerë që qëndron në "eter social", as cilësi që nuk është e lidhur me qytetarin, statusin e tij, nivelin e zhvillimit të qytetërimit dhe treguesit e nivelit publik të tolerancës në qytetërimin tonë. Konceptimi i vlerave të tolerancës qytetare në shoqërinë tonë, jashtë vlerësimit të lidhjeve dhe implikacioneve sociale, nivelit aktual të qytetarisë, është ose tërësisht i gabuar ose krejt i pamundur. Sepse së pari, dhe në mënyrë të padiskutueshme, është e njohur dhe e pranuar e vërteta universale sociale dhe sociologjike, sipas së cilës, "Besimi ndërpersonal dhe toleranca lulëzojnë kur njerëzit ndihen të sigurtë". (Përplasja e ideve, Hartuar nga Gideon Rose dhe Jonathan Tepperman, f 329).

Natyrisht, si çdo qytetërim, edhe qytetërimi ynë ka raportet e veta në përdorimin e këtyre mekanizmave të zgjidhjes së problemeve sociale, të tillë siç janë monologu me veten dhe dialogu me të tjerët. Këto instrumente janë të lidhura me kulturën e qytetërimit tonë, me aftësinë e qëndrimit interqytetar. Kjo do të thotë, se tashmë është koha kur duhet të bëjmë më shumë, për ta bërë aftësinë e dialogut qytetar pjesë

KONGRESI I MANASTIRIT NË KUJTESËN E FISHTËS

Në Kongresin e Manastirit (14 – 22 nëntor 1908) u morën vendime të rëndësishme, për çështjen e alfabetit, apo për ato politike, që ndihmuan për ngritjen në një shkallë më të lartë të kulturës e shkollimit shqiptar, si edhe për bashkimin e mëtejshëm në luftën për çlirimin kombëtar.

At' Gjergj Fishta, me një ndikim të fuqishëm në unifikimin e alfabetit të shqipes, duke e rikujtuar këtë ditë, shkruante:

"Ishim nga të gjitha skajet e Shqipnisë dhe të kolonive shqiptare ndër dhena të hueja. U treguam me të vërtet shqiptar, sepse kurnjani nuk donte me i lëshue asnji fije penit nga mendimi i vet atij tjetrit. Kongresi duhej të shpërndahej pa marrë kurrnji vendim.

– U tërbova nga inati, u çova në kambë e u fola: – O burra shqyptarë, po a me të vërtetë do t'i lamë marre vedit para të gjithë botës?

– Po a mendoni ndopak se çka do t'u thomi shqyptarëve kur të na pvesin se, çka keni ba ju dijetarët atje në Manastir?

– Çka do t'u thomi na njerzve të pashkollë që nuk dijnë as me shkrue as me

këndue?… Na jemi që mendojmë me ba Shqypninë e si do ta bajmë atë kur na nuk duem me u marrë vesht ndërmjet vedit se si duhet me u shkrue germa A e ajoI?

– Burra po u flas me zemër në dorë se asht marre e turp e faqe e zezë me i lanë marre vedit para popullit shqyptar e para tanë botës, që pret dishka prej nesh e na të kthejmë pa kurrgja në dorë ndër shpija tona.

– Po ulnju burra, ulnju sheshit e pse të kalojmë edhe nji ditë ma shumë në kët vend, mos ta lamë duerbosh popullin që na pret!…

– Aferim! P.Gjergj!… Aferim të kjoftë, bërtiti më të madhë një hoxhë me mjekërr. Ai u çue në kambë e erdh drejt te un, e më puthi në ballë e më tha: – Kështu flet shqiptari që e di që asht shqiptar!…

Ulnju burra, – u tha, – ulnju këtu në shesh të zgjedhim një komisjon e në krye të vemë Pader Gjergj Fishten e vetëm komisjoni do të caktojë se shka duhet të bajmë sot-për të mirën e popullit shqiptar neser…

Fjala e tij u ndigjue me duartrokitje e më caktuen Kryetar të Komisionit të Kongresit të Manastirit, i cili do të delte bosh sikur mos të ishte tregue toleranca e eme që të pranojshm dy alfabete njiherit, atë të Stambollit që kërkonte Mit'hat Frashëri dhe këtë që u vendos.

Kjo sjellje e eme në Kongres të Manastirit më ka kushtue mjaft shtrejt në jetë, sepse Abat Doçi, të cilin un e ërfaqësova në atë Kongres m'u idhnue. E kur u ktheva më tha: Pater Gjergj, un të kam dijtë si nieri që nuk ban kompromis në jetë! …

***

22 Nëntor 2025 - 22 Nëntor 1908, 117 vjetori i Kongresit të Manastirit, që e bëri gjuhen shqipe me alfabet të njëhsuar ! E çuditëshme se si kjo datë, nder më të rëndësishmet e historisë sonë kombëtare, u desh të bëheshin 117 vite, që të shpallej festë zyrtare nga Shteti Shqiptar!

Dede Prendaj

◀ përbërëse të rëndësishme të kulturës së qytetërimit tonë, komponent bazë të mënyrës së komportimit social të qytetarëve tanë.

Por kjo punë nuk është e lehtë. Sepse, siç po duket, në shoqërinë shqiptare për fat të keq është duke u zgjeruar atmosfera e sjelljeve intolerante, të cilat herë pas here gjenerojnë konflikte sociale dhe interpersonale, madje edhe duke zgjeruar frikshëm tipologjinë, format e shfaqjes dhe gjeografinë e dhunës. Ne duhet ta pranojmë që sot dhuna është një nga plagët e njohura dhe shumë shqetësuese e virulente të qytetërimit tonë. Në të vërtetë ne kemi dy dekada që jemi më të lirë se kurrë si njerëz, si qytetar dhe si shoqëri në tërësi. Sipas logjikës sociologjike dhe praktikave të mira të qytetërimit europian, dhuna duhet të ishte zmbrapsur nga jeta jonë, sepse "Toleranca është virtyt që del në pah, kur njerëzit janë të lirë dhe zgjedhin fe, besime dhe ide të ndryshme për t'i ndjekur". (Jill Caroll, "Dialogu i Qytetërimeve", f 33)

Padyshim, ne duhet të bëhemi koshientë kur shtrojmë nevojën e zëvendësimit të shpejtë të instrumentave të dhunës me mjetet e shumta të tolerancës qytetare. Kjo do të thotë që si shoqëri duhet të vlerësojmë faktin, që në përgjithësi mekanizmat e tolerancës qytetare në shoqërinë shqiptare janë akoma të brishtë dhe shumë delikatë. Qytetërimi nuk është arenë dhune, por ambient social human, në të cilin jetojnë njerëz, të cilët edhe pse mund të jenë të panjohur dhe mund të kenë konflikte të natyrshme me njëri-tjetrin, kanë gjënë e përbashkët që i lejon dhe mundëson hapësirën e marrëveshjes dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme përmes tolerancës qytetare. Sepse në shoqërinë tonë njerëzit nuk jetojnë dhe nuk janë "detarë në det të panjohur".

Pa shmangur dhunë dhe zgjeruar shtrirjen e tolerancës si instrument i komunikimit social, është e vështirë të mbahet në këmbë shoqëria dhe sistemi i marrëdhënieve qytetare të ndërvarura. Kjo do të thotë që qytetarët tanë duhet të mësohen që të përdorin "busullën e tolerances" qytetare, si mënyrë për të zgjidhur problemet që kanë, duke ndjekur me këmbëngulje rrugën e arsyetimit dhe dialogut qytetar. Përdorimi i dhunës në të gjitha trajtat dhe llojet e ekzistencës, mënyrat e ashpra të shfaqjes në shoqëri dhe në marrëdhëniet midis njerëzve tanë, si mënyrë arkaike për zgjidhjen e problemeve të jetës sociale është i papajtueshëm me natyrën e qytetërimit modern dhe standardet e jetës së qytetëruar.

Kultura e qytetërimit bashkëkohor, rrjedhat e integrimit në standardet e qytetërimit europian, e bëjnë imperative punën që duhet të bëjmë për ta bërë tolerancën "limfë" të shoqërisë, mënyrë jetese të qytetarit, kusht për ndërtimin e praktikave sociale moderne të qytetërimit tonë. Por kjo nuk bëhet në se nuk ndryshojnë principet e vjetra, të deformuara të intolerancës dhe qëndrimit refraktar ndaj mendimeve të tjetrit. Njerëzit tanë kanë nevojë të zotërojnë kulturën e tolerancës humane. Por kjo nuk mund të ndodhë në se nuk i edukojmë njerëzit me idenë e nevojës së sensit human, që në vend të ndryshosh apo të mos pranosh idetë e tjetrit që mund të jenë të kundërta me të tuat, është më mirë të mbash qëndrim tolerant.

Asnjë dyshim nuk duhet të kemi për lidhjen e domosdoshme që duhet vendosur midis tolerancës, përmirësimit të gjendjes shpirtërore të qytetarit dhe përmirësimit të cilësisë dhe standardeve të qytetërimit tonë. Asnjë fitim nuk ka njeriu nga intoleranca dhe agresiviteti i shfaqur në marrëdhënie me të tjerët. Por as qytetërimi ynë nuk është normal me doza kaq të larta neurotizmi social. Vlera sociale e tolerancës në shoqërinë tonë duhet të vijë duke u rritur, sepse prirja individualiste e jetës e bën atë kusht ekzistencial për njeriun, për lidhjet individuale, ndërtimin e nivelit të duhur të marrëdhënieve sociale. Sidomos tani kur koha e ka vënë njeriun përballë thellësive të ndryshueshme dhe realiteteve të rrëshqitshme të jetës moderne në Shqipëri.

Megjithatë nuk mund të pranojmë asnjëherë tezën e disa konservatorëve që thonë se fajin për situatën e ka moderniteti dhe qytetërimi. Përkundrazi, qytetërimi dhe moderniteti është shkak që në shoqërinë e sotme shqiptare ka krijuar këtë gjë të vlefshme siç është toleranca, që është fruit më i madh i qytetërimit dhe jetës qytetare. Qytetërimi dhe moderniteti nuk janë problem. Problemi për ne është që "…ende nuk kemi arritur ta pranojmë atë vlerë, e cila përfshihet në fjalën e vetme që quhet tolerancë". ("Dialogu mes civilizimeve", f 61). Rëndësi ka të kuptohet se toleranca e individit si qytetar, për të cilën ka folur filozofi i shquar Herbert Markuze, është e kondicionuar nga ekzistenca e tolerancës së ngjashme në shoqërinë tonë.

Në një farë mënyre, ky është ekuacioni social që mban të lidhur reciprokisht individin si qytetar tolerant dhe mënyrën e komportimit me shoqërinë liberale shqiptare. Qytetar modern nuk do të thotë individualist kokëfortë, që di vetëm të dialogojë, por pa bërë kompromis. Por problemi nuk është kaq i thjeshtë, sepse gjërat janë ngushtësisht të lidhura dhe në një farë mënyre, nuk mund të flitet për demokraci nëse nuk ekziston apo mungon toleranca. Sepse, në fund të fundit, "Demokracia nuk ka gjasa të mbijetojë në një shoqëri të shkatërruar nga mosbesimi dhe mungesa e tolerancës". (Përplasja e ideve, fq. 329).

I "PIKTURUAR" NGA ZOTI, THETHI 540-VJEÇAR

NDUE ZIÇI

Fshati, i cili njeh vetëm lindje, por asnjë here vdekje, vetëm përparim e prosperitet. Ky është Thethi, i dokumentuar në vitin 1485 në regjistrat e Sanxhakut të Shkodrës, i quajtur me emrin Fusha dhe kishte 7 shtëpi, dy prej të cilave janë edhe sot. Të shpallura muze, shtëpia e Lulash Keqit, në të cilën ka lind edhe gjyshi im i quajtur Gjergj Pjetrushi, dhe shtëpia tjetër e Zef Koçekut. Siç vërtetohet nga dokumentet, këtë vit Thethi ka mbushur plot 540 vjet.

Ky fshat është pjesë e krahinës së Shalës. Por sipas studimeve nga arkeolog vendas e të huaj në Grunas rreth 100 ml nga katarakti me të njëjtin emër, është zbuluar se ka pasur një vend banim rreth 800 vite para lindjes Krishtit.

Shala përbëhet nga katër vëllazëri dhe këto janë sipas 4 vëllezërve, djemtë e Nik Pecit, të cilët quheshin Peci, Deda, Loti e Lekë Nika. Gjithnjë sipas gojë dhënave, vëllezërit u ndanë dhe Dedë Nikës i takojë Thethi për pjese. Pra, i buzëqeshi fati dhe i takojë per pjese Thethi.

Dedë Nika kishte 5 djem të quajtur: Vuksani, Gjeçi, Marku, Ndreu dhe Liçi - Deda. Sipas këtyre emrave janë ndarë edhe lagjet e Thethit. Vuksanajt (Okoli dhe Kolajt), Gjeçajt (Gjeçajt), Marku (Nikgjonajt e Gjelajt), Ndrejajt (Nderjaj e Ulaj), Aliçaj (Grunasi dhe Nderelysa).

Nuk dua të ndalem shumë te historia. Është bërë historia e përsëri duhen volume të shkruara e përsëri nuk thuhen të gjitha për Thethin. Është bërë historia dhe janë shkruar volume e volume, por nuk ka qenë mjaftueshëm për Thethin.

Të ndalemi te titull i i këtij shkrimi se, Zoti ka qenë me leje të zakonshme, kur ka krijuar Thethin.

Sipërfaqja e tij është 2630 km2, duke përfshirë edhe Rragamin e Shalës. Nga kjo sipërfaqe burojnë dy lumenjtë më të bukur në Evropë, lumi i Shalës dhe i Valbonës. Në burim ata nxjerrin 2.5 – 3 m3 ujë në sekondë. Kjo perlë e natyrës Shqiptare ka qenë e lakmuar shumë nga pushtuesit turq, serb e malazes. Thethi është vizituar e kanë shkruar historian, gjeograf, astrolog, ambientalist, madje edhe alpinistë. Për here të pare Thethi shfaqet në hartë, në vitin 1668 nga Ceneroli. Ashtu siç kanë shkruar Shuflaj, Edit Durham e të tjerë, e të tjerë. Bukurit Thethit ja shtojnë malet, të cilat e rrethojnë, si maja e Radohimës, Shebenikut, Paplukës, me lartësi deri në 2500 m.

Ndërsa vet lugina ka një lartësi mbi nivelin e detit nga 750 m deri në 950 m. Tiparet e popullit janë si ato të Shalës e Dukagjinit. Trimëria, bujaria, besa, mikpritja e të tjera. Janë sulmuar disa here, për ta pushtuar e për t'i ulur krenarinë, as një here nuk ja kanë arrite qëllimit. Janë kthyer prapa me turp. Ashtu si populli i Shalës, Dukagjinit edhe Thethjanet janë autokton tani mbi 5 shekuj. Pronat janë gjë e shenjte për këta banor.

Kufijtë në mes familjeve, lagjeve dhe vëllezërve e fiseve, janë të caktuar me shekuj. Kjo e trashëguar mbi 15 breza. Theksojmë në këtë fshat asnjë herë nuk ka pasur ngatërresa, se për vrasje nuk bëhet fjalë. Lotin e gëzimit e të hidhërimit e kanë nda bashkë. Pra, vërtetohet se janë shumë të lidhur. Marrëdhëniet me fqinjët kanë qenë shumë të mira.

Thethi kufizohet me Malësinë e Madhe, Krasniqe, Nikaj- Mertur e të tjera. Nuk ka qenë rastësi kur Dede Gjon Luli ishte i dënuar me vdekje e jo vetëm ky, por edhe ata të cilët e strehojnë ishin të dënuar me vdekje. Po ai gjeti strehim në Theth te Lul Gjoka. Ai e dinte se besa ishte më e rëndësishme se djali në Dukagjin.

Krahas pushtuesve të huaj,. Dukagjinin e sulmoi edhe regjimi i Zogut, i cili dërgoi, forcat mercenare, për ta nënshtruar të udhëhequra nga Muharrem Bajraktari e Preng Previzi. Organizuan me qindra forca mercenare nga Luma e Kukësit, për të nënshtruar Dukagjinin. Reprezaljeve nuk i shpëtojë as Thethi. U arrestuan e torturuan me dhjetëra Thethjanë, u dogjën shtëpia, madje edhe Kishën e Thethit të ndërtuar në vitin 1892. Po të njëjtën gjë bënë regjimi Monistt, të cilët e dogjën përsëri. Falë bashkësisë shqiptar në SH. B. A. u ringrit përsëri e qëndron si ikonë në zemër të fshatit e të Alpeve.

Këto forca mercenare arritën që edhe të varin në litar Kole Markun. Në mesin e të burgosurve ishte edhe Vate Smajli, djalë i vetëm, që vdiq në burgun e Durrësit.

Lidhur me pronësinë në Theth, nuk ka pasur asnjë probleme.

Në vitin 1947, regjimi i kohës, bëri regjistrimin e pronave, duke ngritur komisione të posaçme. Regjistrimi u bë në prani të kryefamiljarëve dhe sipas kufijve të trashëguar në shekuj. Të bije në sy, se në pronën e familjes sonë, diferenca me matjet me topograf lëviznin vetëm dy m2. Regjistrimi i pronave në vitin 1947, është bërë, për të dokumentuar pronat e gjithsecilit. Në bazë të këtij regjistrimit çdo familje paguante taksat me produkte mish, lesh dhe vezë. Hartat dhe faturat e paguara në vite, i disponojnë sot shumë familje.

Pas vitit 1990, kur kooperativat bujqësore u shpërbën, se cili fshatar mori tokat sipas regjistrimit të vitit 1947.

Shpopullimi i fshatit ishte një dramë, kjo si në të gjithë Shqipërinë. Në vitin 1987 Thethi kishte 147 familje, me 1300 banor. Në vitin 2000 në Theth jetonin vetëm 74 familje me 650 banor. Po nga viti 2000, përsëri kanë ardhur duke u larguar shumë familje. Ndonëse vitet e fundit filluan të kthehen shumë, madje emigrant nga shtetet e ndryshme.

Ngjarjet e fundit, e kemi fjalën për prishjen e ndërtimeve, mungesa e regjistrimit të pronave e certifikimi i tyre, i zhgënjeu shumë.

Le të shkojmë shumë larg në histori. Shteti mbështetet në katër kolona: 1- Ruajtja e kufijve. 2- Regjistrimi i popullsisë. 3- Regjistrimi i pronave. 4- Rendi e qetësia. Te dy të parat nuk do të ndalem, se ato dihen se si janë! Ndërsa për regjistrimin e pronave, sikur të ishin regjistruar pronat, secili të kishte certifikatën e pronësisë mbi token edhe ndërtimet do bëheshin me leje.

Në muajin korrik të këtij viti, u përjetua një situatë e rëndë për banorët e Thethit. Dëmi i prishjes, të këtyre ndërtimeve, arrin në 15 milion ero. Djersa e dhjetëra banorëve, emigranteve, të tjera të marrua borxh në banka e individ u shkërmoqen menjëherë, shteti përdori forcën fizike e psikologjike. Presioni ishte i madh ndaj një popullate të pambrojtur. Nuk kursyen as invalidët, gratë e fëmijët e çuditshme! Të shqetëson nxitimi i madh i shtetit, kur mund të shtyhej deri me 15 shtator, duke ju dhënë afat, për t'i hequr vet. Në të kundërt të veprojë shteti.

Zbarkimi i një shteti të tërë, duke përfshirë IKMT, IMT, policinë e rendit, forcat speciale, si i thonë fjalës hurit e konopit, ndaj një popullsie të qetë e të kulturuar siç kanë qenë e janë thethjanët. Prishjet e ndërtimeve edhe priteshin, por jo ofendimet duke filluar me fjalët malok, shpellar e duke arrite nga komandanti i operacionit të shajë me libër shpie, pa kulturën minimale të një punonjësi shtetit. Ndonëse nuk pati varje në litar, as djegia shtëpish, por shembjen e mbi 100 objekteve, duke përdorur edhe lëndë plasëse, e të tjera. Po të ishin gjallë ata që kanë përcjellë turqit, serbet apo mercenaret e mbretit Zog , do jua kishin zili. Shumë emigrant u kthyen në fshat për të investuar, duke u bazuar në propagandën e qeverisë. Ndërtimet e bëra janë në tokë të trashëguar nga të parët. Me shpresën se do ju legalizohen. Një emigrant i ardhur nga Amerika, investoi 400 mijë ero. Mundi e djersa e tij, kursimet e mbi 20 viteve, u shkatërruan për 10 minuta. Faji është një qyrk që nuk donë me vesh asnjë njeri. Për këtë që ndodhi, faji ndahet në disa drejtime.

Banorët autokton të Thethit, shkelen besën e dhënë në kishë. Se toka e Thethit nuk do shitet kurrkujt veç thethjaneve. Përgjegjësi kanë shitësi e blerësi, se shitblerja bëhet me dokumente ligjor. Për rastin, konkret certifikatë e pronësis,ë e cila nuk ekziston. Ndërtuesit para se të ndërtonin e të hedhin gjithë ato para, ata duhet të konsultoheshin me juristet. Thethi ka me dhjetëra të tillë. Përgjegjësi ka edhe shteti me administratën e tij vendore. Këto ndërtime nuk u bënë brenda ditës as javës! Dyshohet për ndonjë "kompromis" në kesh.

Të kthehemi te titulli i shkrimit.

Ato fakte historike i bëra të ditura, për të treguar se Dukagjini, pra edhe Thethi, janë autokton në trojet e tyre. Pra nuk janë tokë "xanun". Ndërtimet e bëra në Theth, nga persona që nuk janë banor në këtë fshat, ja kanë blerë ndonjë banori thethjanë. Askush nuk mund të ndërtonte si bije fjala në Bathore, në zonën e kënetës në Durrës etj. Këtë perlë të alpeve Shqiptare e lakmojnë shumë kompani a individ të pasur.

Po Thethi nuk është plaçkë tregu, nuk shitet as nuk tjetërsohet. Është një kafshatë e forte, dhe nuk ka mundësi ta kapërdijnë as të pasurit as të fortët, me siguri do ju mbetet në fyt.

Nëse shteti do që zonat malore të zhvillohen, të zbatojë vendimin e qeverisë 20/20, të bëjnë mastar planin, duke ju përshtatur, ndërtimeve tradicionale të zonës, në shekuj.

Duke e mbyllë këtë shkrim, një falënderim me mirënjohje, shkon për paraardhësit tone, të cilët na lanë trashëgim Thethin, e "Pikturuar nga zoti".

Gjithashtu shpresojmë se do vijë dita kur të festojmë 541 vjetorin e Thethit, me prona të regjistruara e të dokumentuara.

ARTI, MBIJETESA KOMBËTARE: DIJA, RRUGË DREJT SHPËTIMIT SHPIRTËROR

Drama e një shpirti që kërkon njohje, drejtësi dhe dritë për një komb

Bashkëbisedimi ekskluzive me shkrimtarin dhe publicistin Brahim (Ibish) Avdyli, e realizuar nga gazetari Dashnim Hebibi, paraqet një rrëfim të thellë, emocional dhe reflektues mbi jetën, veprën dhe filozofinë jetësore të një intelektuali të përkushtuar ndaj kombit dhe kulturës shqiptare.

Brahim Avdyli paraqitet si një figurë poliedrike: shkrimtar, publicist, gazetar dhe aktivist politik e kombëtar. I lindur më 5 shtator 1960 në Morinë të Gjakovës, ai jeton në Zvicër prej dekadash, duke mbetur i lidhur shpirtërisht me atdheun, pavarësisht braktisjeve, sprovave shëndetësore dhe vështirësive ekonomike.

Ai është përfaqësues i atij brezi intelektualësh që u formuan nën shtypjen e regjimit jugosllav dhe që në mërgim nuk e harruan kurrë misionin e tyre kombëtar.

Në bashkëbisedim vihen në pah disa nga veprat më të rëndësishme të autorit, që përfshijnë një gamë të gjerë zhanresh, duke nisur nga publicistika dhe analiza deri te proza e poezia. Ndër to spikasin: "Sondazhe për Kosovën e kufirin e saj" (2019), vepër me karakter dokumentar dhe politik, që trajton kufijtë historikë të Dardanisë dhe padrejtësitë ndaj Kosovës; "Bota shpirtërore në krijime të veçanta" (2023), përmbledhje studimore që synon të bashkojë në mënyrë shpirtërore të gjitha trojet shqiptare; "Nëpër tingujt e zemrës" (2022), tri novela me temë kombëtare e autobiografike; "Thikat e mllefit" (2024), përmbledhje poetike që shpalos lirizmin dramatik të humbjeve dhe ringjalljeve njerëzore etj.

Këto vepra e përshkruajnë Avdylin si një autor me vizion të gjerë kombëtar, me ndërthurje të artit, historisë dhe filozofisë, që përdor letërsinë si mjet për të afirmuar identitetin shqiptar dhe për të ndriçuar të vërtetën historike.

Një pjesë e madhe e intervistës është e mbushur me reflektime mbi mërgimin, dhimbjen e ndarjes dhe përvojën e një jete të jetuar mes dy botësh: atdheut dhe mërgatës. Avdyli përshkruan largimin e tij nga Kosova si një akt të detyruar, të ndikuar nga përndjekja politike dhe kërcënimet ndaj jetës së tij, që nga demonstratat e vitit 1981. Në Zvicër, ai jo vetëm që gjeti strehë, por u shndërrua në një zë të diasporës shqiptare, duke themeluar dhe drejtuar revistën "Qëndresa" (1990-1995), një platformë e rëndësishme për mendimin kombëtar në mërgim. Megjithatë, Avdyli nuk fsheh zhgënjimin dhe vetminë që e kanë shoqëruar. Ai flet me ndjeshmëri për izolimin shpirtëror, mungesën e njohjes, ndarjen nga familja dhe ndjenjën e mospërfilljes nga bashkëkombësit dhe politika shqiptare. Në përgjigjet e tij, përdor një gjuhë të ngarkuar me simbolikë, duke përzier elemente filozofike, metafizike e mistike. Ai flet për "të mirën" dhe "të ligën" si forca universale që ndikojnë në jetën e njeriut, për demonët që ndjekin mendjen dhe për engjëjt që ndriçojnë rrugën e së vërtetës. Në këtë aspekt, intervista shkon përtej rrëfimit biografik dhe bëhet një meditim mbi ekzistencën, drejtësinë, dijen dhe fatin e kombit shqiptar në raport me botën moderne.

Avdyli e sheh veten si pjesë të pandarë të misionit kombëtar. Ai e konsideron çështjen shqiptare ende të papërfunduar dhe flet me pasion për bashkimin shpirtëror e territorial të shqiptarëve. Në interpretimin e tij historik, ai lidh lashtësinë e shqiptarëve me qytetërimet iliro-pellazge, duke u përpjekur të zbulojë rrënjët e vërteta të identitetit tonë kombëtar.

Kjo bisedë mediatike është një dëshmi e rrallë e përkushtimit, vuajtjes dhe qëndresës intelektuale. Ajo ngërthen në vetvete biografinë e një njeriu që i ka kushtuar jetën fjalës, dijes dhe kombit, shpesh në heshtje e pa mbështetje institucionale.

Nëpërmjet rrëfimit të tij, lexuesi ndesh jo vetëm një krijues të përvuajtur, por edhe një mendimtar që kërkon të kuptojë kuptimin e së vërtetës në një botë të dominuar nga gënjeshtrat dhe politika e interesit. Në thelb, kjo intervistë nuk është vetëm një bisedë me një shkrimtar, por një dokument shpirtëror që pasqyron dramën e intelektualit shqiptar në mërgim, të përndjekur nga idealet e larta dhe të harruar nga shoqëria që ai deshi t'i shërbejë.

I bashkëbiseduar nga Dashnim Hebibi, bashkëbisedimi me shkrimtarin e diasporës shqiptare vjen e gjerë, e thellë dhe e ngarkuar emocionalisht. Ajo përbën një dëshmi të rrallë të një intelektuali që flet pa frikë për të vërtetën kombëtare, për dështimet e politikës, për dhimbjet e mërgimit dhe për idealin e bashkimit gjithëshqiptar. Avdyli shpreh hapur zhgënjimin me "çështjen shqiptare" ende të pazgjidhur, duke theksuar se "asgjë nuk është gjithëkombëtare, përveç problemit tonë". Sipas tij, shqiptarët janë shpërndarë në copëza shtetërore e politike, ndërkohë që vendet fqinje vazhdojnë të përfitojnë nga dobësia jonë e përçarja e brendshme. Në këtë kuptim, Avdyli paraqet një vizion të qartë kritik ndaj politikës aktuale shqiptare, të cilën e sheh si të shitur, të korruptuar dhe të ndarë nga interesat kombëtare. Ai përmend Preshevën, Bujanocin, Medvegjën dhe Çamërinë si plagë ende të hapura të kombit, duke i parë si pjesë të pandashme të "Shqipërisë së madhe shpirtërore".

Vetmia e intelektualit dhe harresa e mërgatës

Një nga shtyllat më të forta të bashkëbisedimit, është rrëfimi për mërgatën shqiptare, të harruar, të shpërfillur e të përjashtuar nga vendimmarrja. Ai përmend përpjekjet e tij si Kryesues i Komisionit të Intelektualëve Shqiptarë të Kosovës (ISHK). Por, pavarësisht këtij kontributi, Avdyli ndien se ai dhe bashkëmendimtarët e tij janë lënë pas dore, pa respekt e pa përkrahje institucionale. Kjo pjesë e intervistës përçon një ndjesi të thellë zhgënjimi, por edhe krenarie: krenarie të një njeriu që nuk ka pushuar së vepruari, edhe pse tashmë i lënë në harresë. Në analizat e tij, Avdyli i shikon fenomenet politike e shoqërore përmes një prizmi moral dhe metafizik. Ai flet për "gjarprin në mes të tryezës politike", për "shpirtrat e ligj" që helmojnë njeriun dhe për demonët që udhëheqin shoqërinë. Kjo gjuhë simbolike e ngarkon intervistën me një dimension filozofik, ku e mira dhe e liga shfaqen si forca të përhershme në luftë për shpirtin e kombit. Ai kritikon ashpër "poli-a-tikën", duke e ndarë këtë fjalë për të treguar shumëllojshmërinë dhe ndotjen e politikës, dhe e cilëson atë si arenë ku helmohet çdo ideal kombëtar.

Avdyli flet me dhimbje për krijimtarinë e tij letrare, të shkruar në vetmi, varfëri dhe sëmundje. Ai e përshkruan procesin e shkrimit si një përpjekje për të mbijetuar shpirtërisht. Ndër veprat e tij, ai përmend: "Vetëvrasja e një poeti", "Nëpër telat e zemrës", "Sondazhe për Kosovën dhe kufirin e saj", si dhe një sërë librash të papërfunduar, përfshirë studime, poezi, drama dhe romane. Krijimtaria e tij është një formë qëndrese, një mënyrë për të ruajtur kujtesën dhe shpirtin shqiptar në mërgim. Autori tregon shqetësim për ndikimin e teknologjisë moderne në kulturë. Ai e sheh digjitalizimin si "armik të librit", që po e shkatërron leximin tradicional dhe po e zëvendëson me varësi teknologjike. Për Avdylin, kjo është një formë tjetër e kontrollit dhe humbjes së mendimit të lirë. Në fund, Avdyli jep një porosi të fuqishme për të rinjtë: të ndjekin dijen, kulturën, dritën dhe bashkimin. Duke e përkufizuar dijen si rrugën e vetme drejt shpëtimit shpirtëror e kombëtar, thekson se "dija është dritë, padija është errësirë". Ai kërkon që brezat e rinj të ruajnë rrënjët e tyre, të mos asimilohen dhe të punojnë për bashkimin shpirtëror të shqiptarëve, përtej feve, racave dhe kufijve.

Ky bashkëbisedim, është një mozaik rrëfimesh, dhimbjesh dhe urtësish. Avdyli del si një figurë e sinqertë, e papërkulur dhe e thellë, që flet me shpirt për plagët e kombit dhe për përvojën personale të një shkrimtari në mërgim. Ai nuk kursen kritika ndaj askujt, as ndaj vetes. Në fund, kur pyetet "çfarë nuk ia fal vetes", ai përgjigjet:

"Asgjë nuk ia fali vetes!". Kjo fjali sintetizon gjithë dramën e tij: njeriun që kërkon të vërtetën, por që mbetet i vetëm në mes të një bote të padrejtë.

Në thelb, kjo intervistë nuk është vetëm një bisedë me një shkrimtar, por një dokument i rrallë i ndërgjegjes shqiptare, një rrëfim që ndërthur historinë, filozofinë, religjionin, letërsinë dhe politikën në një përpjekje të sinqertë për ta kuptuar fatin e kombit tonë në shekullin XXI.

***

Botimi që kemi në duar sjell edhe një tjetër intervistë dokumentare me shkrimtarin, publicistin Brahim (Ibish) Avdyli, një figurë e njohur e letrave shqipe dhe e diasporës shqiptare në Zvicër. Në këtë tekst ai shpalos biografinë personale dhe profesionale, veprimtarinë si krijues, gazetar dhe studiues; krijimtarinë e gjerë letrare ku përfshihen poezi, prozë, drama, e publicistikë. Ai përmend përvojat e vështira të jetës, ndalimet, humbjet, burgjet dhe pengesat e ndryshme që kanë ndikuar në veprën e tij. Në intervistën përballë Isuf Bajramit, Avdyli flet për frymën e tij krijuese, duke theksuar se e sheh veten si krijues, më shumë sesa vetëm si shkrimtar; stilet e ndryshme të shkrimit, që variojnë nga letërsia poetike e metaforike deri te studimet shkencore e publicistika; përkushtimin ndaj çështjes kombëtare shqiptare, duke kritikuar qeveritë e korruptuara dhe mungesën e një vetëdije të vërtetë kombëtare; humbjen e veprave të tij për shkak të rrethanave politike, grabitjeve dhe ndërhyrjeve të shërbimeve sekrete gjatë viteve të Jugosllavisë dhe më pas. Në pjesën e fundit të intervistës, trajton qasjen ndaj çështjes shqiptare, duke e parë kombin si të copëtuar, të mashtruar nga brenda dhe nga jashtë, por gjithsesi të fortë në rrënjët e tij ilire dhe dardane. Ai shfaq një ton kritik, patriotik dhe filozofik, duke e lidhur gjithnjë letërsinë me misionin kombëtar.

I bashkëbiseduar nga Gëzim Ajgeraj, ky bashkëbisedim me Brahim Avdylin është ndër më tronditëset e gjithë rrëfimit të tij jetësor dhe intelektual. Ajo përfaqëson një dëshmi personale, politike dhe shpirtërore të një njeriu që e ka kaluar jetën në përndjekje, kërcënime dhe sakrifica për çështjen kombëtare shqiptare. Në këtë rrëfim, Avdyli zbulon për herë të parë publikisht detaje dramatike nga jeta e tij personale. Ai përshkruan me një realizëm të ftohtë dhe emocional një seri atentatesh, që, sipas tij, janë organizuar nga struktura të lidhura me shërbimet serbe. Këto përvoja e kanë shndërruar atë në një figurë të qëndresës, të bindur se "nuk i trembet vdekjes" dhe se. Këto rrëfime e vendosin Avdylin në rolin e një dëshmitari të një kohe të errët, ku fjalët, shkrimet dhe mendimi i lirë rrezikoheshin me jetë. Një pjesë e fortë e kësaj interviste është kritika e drejtpërdrejtë ndaj mosinteresimit të mediave shqiptare për rastin e tij dhe për çështjet madhore kombëtare. Ai thekson se "asnjë gazetë nuk ka shkruar asnjë rresht për mua", duke e parë këtë si pasojë të bllokimit informativ që, sipas tij, kontrollohet nga "klanet e brendshme të lidhura me Serbinë".

Më tej, në bisedën me intervistuesin, Avdyli përshkruan me qartësi filozofinë e tij politike kombëtare. Ai e ndan politikën shqiptare në dy rryma:

Vija parciale, që ndjek ndarjet administrative dhe interesat e ngushta partiak:

Vija integrale, që synon zgjidhjen e plotë të çështjes kombëtare shqiptare në të gjitha trojet ku flitet shqip dhe ku "bukës i thonë bukë e ujit ujë."

Për Avdylin, integriteti kombëtar nuk është vetëm politik, por shpirtëror, kulturor dhe ekonomik. Ai propozon bashkim përmes vetëdijes kombëtare, bashkëpunimit ekonomik dhe dijes, jo përmes luftës, duke e parë këtë si rrugën e vetme drejt një lirie të vërtetë, jo të rreme.

Kombi, gjuha dhe identiteti

Në një pjesë filozofike e historike të intervistës, ai sjell tezën se shqiptarët janë pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve dhe dardanëve, duke pretenduar se gjuha shqipe është "gjuha e parë simbolike e njerëzimit." Ai përmend shembuj nga toponimia evropiane (si: "Alba Longa", "Schwäbische Alb", "Britania") për të argumentuar lashtësinë e elementit "Alb" si rrënjë e identitetit shqiptar. Ky interpretim, megjithëse i debatuar, shfaq qartësisht botëkuptimin idealist dhe historik të autorit, që përpiqet të ndërtojë një identitet kombëtar mbi bazën e krenarisë dhe trashëgimisë së lashtë.

Në përmbyllje, Avdyli dërgon një mesazh të fortë për lexuesin: "Leximi është dije dhe dija i nxjerr zgjidhjet, për çdo kohë! Kush lexon, nuk gabon. Gabimi është pa dije." Ky përfundim sintetizon gjithë filozofinë e tij jetësore se vetëm dija, ndërgjegjja dhe bashkimi shpirtëror mund ta shpëtojnë kombin shqiptar nga errësira e përçarjeve, mashtrimeve dhe pushtimeve të reja.

Kjo intervistë është një rrëfim dramatik, patriotik dhe filozofik. Ajo shpalos një njeri të lënduar nga jeta, por të pathyeshëm në shpirt, një krijues që jeton në mërgim, por që mban gjallë idealin e kombit të bashkuar. Në të gërshetohen dhimbja personale, urtësia filozofike dhe zëri i një intelektuali që kërkon të zgjojë vetëdijen e një kombi të lodhur nga politika, por që ende ka shpresë për ringjallje.

***

Bashkëbisedimi i tretë me Brahim (Ibish) Avdylin bëhet nga Gëzim Ajgeraj, ku fjalët marrin peshën e përvojës dhe plagës historike. Në këtë bisedë, Avdyli shfaqet si krijues që jeton në përthyerje mes dhimbjes dhe misionit, mes mërgimit dhe rrënjës, duke ndërtuar një urë të fortë midis letërsisë, publicistikës dhe fushës së kërkimeve. Avdyli e përshkruan jetën në mërgatë jo si një arratisje, por si një vazhdim të luftës shpirtërore për identitet dhe dinjitet. "Të jesh shqiptar në mërgatë do të thotë të jesh edhe i përbuzur", - thotë ai, duke e përmbledhur me pak fjalë fatin historik të shqiptarëve jashtë atdheut. Për Avdylin, mërgata nuk është vetëm hapësirë gjeografike, por një gjendje e shpirtit kolektiv shqiptar, e mbushur me mall, përplasje, vetmi dhe mungesë drejtësie. Në këtë kontekst, krijimtaria e tij lind si akt kujtese dhe kthimi simbolik në atdhe: "Kur shkruajmë, është kthimi ynë në Atdhe." Kjo fjali shënon thelbin e filozofisë së tij krijuese: shkrimi është forma më e lartë e mbijetesës kombëtare.

Krijimtaria si lidhje mes artit, shkencës dhe kombit

Avdyli është një autor që përpiqet të ndërthurë në mënyrë të vetëdijshme artin e fjalës me kërkimin dhe rrëfimin historik me mitin kombëtar. Ai i referohet dijetarëve, si Dhimitër Pilika dhe Sami Frashëri për të ndërtuar argumentin e vijimësisë etnike dhe kulturore të shqiptarëve që nga pellazgët e lashtë deri në ditët tona. Për të, lashtësia nuk është mit, por realitet i mohuar, që duhet rikthyer në ndërgjegjen e kombit.

Në këtë rrjedhë, ai e sheh krijimtarinë si një mision ndërgjegjësimi. Në fjalët e tij ndjehet përpjekja për të mbrojtur identitetin, gjuhën dhe historinë nga "harresa" që ia imponon Europa dhe nga "keqinterpretimet" që i përhapin fqinjët. Ai thotë me dhembje: "Europa nuk na njeh; nuk na sheh dhe nuk na vlerëson si të tillë." Kjo është një thirrje e qartë për rikthim te vetëdija kombëtare dhe për njohje të vetvetes përmes dijes dhe kulturës.

Nga krijimtaria e tij e gjerë, Avdyli ndalet veçanërisht te drama "Gremina", një vepër që ndërthur historinë, metafizikën dhe realitetin politik shqiptar. Ai e sheh këtë dramë si një akt artistik dhe një dëshmi historike që ngërthen në vetvete tragjedinë e kombit dhe shpirtin e tij hyjnor. "Gremina" është metaforë e rënies dhe ringjalljes, ku mitologjia pellazge, Zoti, Engjëlli dhe Shkrimtari përfaqësojnë rrugëtimin e njeriut shqiptar përmes shekujve. Në këtë mënyrë, drama bëhet një alegori e historisë sonë kolektive, që nga antikiteti deri te realiteti i sotëm politik e kulturor. Edhe pse i ndjekur nga humbjet, fatkeqësitë dhe përndjekjet, Avdyli mbetet një zë i pathyeshëm i mërgatës shqiptare, një njeri që ka vendosur ta flasë të vërtetën përmes artit. Ai shpjegon se për shumë vite e ndërpreu komunikimin publik, sepse "bota e kishte bërë veshin e shurdhët", por tani rikthehet për të dëshmuar se fjala është arma më e fortë e një kombi të plagosur.

Intervista me Brahim Avdylin është shumë më tepër se një bisedë: është rrëfim i një jete të munduar, por të përkushtuar ndaj idealit të kombit dhe fjalës së lirë. Ajo shfaq një njeri që nuk e ndan artin nga identiteti, dijen nga historia, dhe dhimbjen nga dashuria për Atdheun. Në çdo përgjigje ndjehet përkushtimi i një krijuesi që e sheh shkrimin si mision shpirtëror, si formë e rezistencës kulturore dhe si amanet për brezat që do të vijnë.

"Vetëvrasja e një poeti", dramë e shpirtrave të kryqëzuar

Emocioni arrin kulmin kur Avdyli përqendrohet në bisedën për veprën dramatike "Vetëvrasja e një poeti", e cila sipas autorit përfaqëson një dramë televizive të karakterit historik, mitik dhe filozofik, ku ndërthuren realiteti dhe metafora, historia dhe mitologjia, Zoti dhe njeriu. Këtu ai shfaqet në një dimension më të thellë artistik e filozofik, ku fjalët tejkalojnë përvojën personale dhe shndërrohen në një manifest kulturor dhe kombëtar. Tema qendrore e veprës lidhet me të vërtetën e mohuar historike të shqiptarëve. Ai e shpjegon me pasion se "katër armiqtë përreth nesh" kanë krijuar "kanale të frikës" për të bllokuar shqiptarët nga faktet dhe historia e tyre e lashtë. Për të, shqiptarët nuk janë thjesht pasardhës të ilirëve, por trashëgimtarë të drejtpërdrejtë të "yllirëve" dhe "pellazgëve hyjnorë", duke u mbështetur në mendimet e studiuesve si Muzafer Korkuti dhe Dhimitër Pilika.

Në këtë kontekst, ai citon me domethënie të thellë: "Zoti pellazg thotë: prej jush ka filluar kultura e lavdia, dhe një ditë prapë te ju do të kthehet." Ky është, në fakt, moti shpirtëror i gjithë krijimtarisë së Avdylit: rikthimi te origjina, te rrënja e lashtë e njerëzimit që sipas tij gjendet te shqiptarët. Autori e përshkruan dramën si kryqëzim të kohërave, fateve dhe ideve, ku linjat diakronike (historike) dhe sinkronike (aktuale) përplasen në një tablo të vetme. Kryepersonazhi, Florian Meta, përfaqëson poetin e kombit, njeriun që nuk kuptohet, që përjashtohet nga të vetët dhe që përballet me botën e pandjeshme e të shtrembëruar. "Vetëvrasja" është simbolike, një akt shpirtëror, një përpjekje për të vrarë errësirën e botës përreth me dritën e artit. "Ai nuk ka çka të bëjë pos të vrasë vetveten, pasi i ka lënë të gjitha dëshmitë në arkivat e shtetit ku jeton", thotë autori. Por Zoti, në dramë, nuk e lejon të vdesë sepse misioni i tij nuk ka përfunduar. Kështu, "vetëvrasja" kthehet në ringjallje shpirtërore dhe artistike, në një metaforë të pavdekësisë së fjalës. Avdyli sqaron se vepra nuk është "dramë klasike", por dramë televizive, e ndërtuar për t'u parë dhe përjetuar vizualisht. Personazhesi: shqiponja, sorra, zogjtë, macja dhe qentë janë pjesë e saj, çka e bën veprën simbolike. Në këtë mënyrë, natyra vetë bëhet pjesë e dramës, një aktor hyjnor dhe metafizik që e bashkon njeriun me Zotin dhe me historinë. Edhe natyra e ka domethënien e vet në këtë vepër, duke i dhënë dramës karakterin e një epopeje vizuale dhe shpirtërore.

Promovimi i dramës në Gjakovë, sipas Avdylit, ishte një moment kthimi pas shumë vitesh heshtjeje dhe vuajtjeje. Ai falënderon me përzemërsi kritikët, miqtë dhe lexuesit që e kanë mbështetur, duke theksuar se ky promovim ishte një "kurorëzim shpirtëror" i krijimtarisë së tij. Në vend që të fliste për veprën, autori zgjodhi të flasë për kritikën dhe kuptimin e tekstit, duke i ftuar lexuesit të mendojnë vetë dhe të nxjerrin kuptimet e tyre. Në përmbyllje, Avdyli lëshon një thirrje të fuqishme për vetëdije kombëtare dhe kulturore. Ai u drejtohet me shqetësim lexuesve të rinj, të cilët "nuk lexojnë më, sepse interneti ua ka marrë shpirtin e librit." Kështu nuk e njohin të vërtetën e kombit të vet. Ata përsërisin gënjeshtrat që ua kanë mësuar të huajt. Sipas tij, historia botërore duhet rishikuar, sepse është e ndërtuar mbi "pseudoshkencë". Vetëm e vërteta, mund të çlirojë njeriun dhe kombin.

Përgjithësisht, Brahim Avdyli na paraqitet si një autor me ndërthurje midis artit, historisë dhe filozofisë kombëtare. "Vetëvrasja e një poeti" nuk është vetëm dramë për një njeri; është dramë për një komb, për një shpirt që kërkon njohje, drejtësi dhe dritë. Në çdo fjali, Avdyli e shpall artin si formë të mbijetesës kombëtare dhe dijen si rrugë drejt shpëtimit shpirtëror.

Brahim (Ibish) AVDYLI,
shkrimtar dhe publicist,
Gjakovë, 25. 10. 2025

TESTAMENT SHPIRTËROR I NJË JETE TË TËRË

Vështrim kritik mbi vëllimin "PIKLA NGA QIELLI" të autorit TAHIR BEZHANI

Prof. Dr. Migena Arllati,
*autore e tekstit studimor**

Krijimtaria poetike e Tahir Bezhanit, tashmë e shtrirë në 28 vëllime, paraqet një univers të gjerë tematik dhe emocional, që lëviz midis kujtesës, dhimbjes, dashurisë dhe përjetësisë. Poezia e tij ndërtohet mbi përvojën njerëzore, historike dhe shpirtërore të një brezi që ka njohur humbjen, mërgimin dhe përpjekjen për ta ruajtur identitetin në një botë që ndryshon pa mëshirë. Në thelb, kemi të bëjmë me një poet të kujtesës dhe të qëndresës, ku vargu bëhet jo vetëm mjet shprehjeje, por edhe mjet shpëtimi, një strehë për shpirtin e lodhur e për kombin e plagosur.

Në planin tematik, poezia e tij është e mbushur me motive të forta identitare dhe filozofike. Simbolet e përsëritura: kulla, guri, lisi, zjarri, pasqyra, dritarja, shkopi, vargu etj., janë elemente që përbëjnë një sistem të qëndrueshëm poetik, përmes të cilit autori e lexon jetën dhe kohën. Kulla, për shembull, nuk është vetëm një ndërtim fizik, por simbol i dinjitetit, i burrërisë dhe i trashëgimisë shpirtërore. Guri është qëndrueshmëria e qenies, ndërsa pasqyra e thyer përfaqëson ndërgjegjen e copëtuar nga vuajtjet e jetës. Këto figura mbartin gjithnjë dy dimensione: personal dhe kolektiv, duke e bërë poezinë e tij të njohshme e njëkohësisht universale.

Kjo përmbledhje poezish, e titulluar "Pikla nga qielli" bart një frymë të thellë melankolie ekzistenciale, ku autori shfaq ndjeshmëri të hollë ndaj kohës, vetmisë, pritjes, dashurisë dhe zhgënjimit njerëzor. Në thelb, poezitë përbëjnë një udhëtim shpirtëror që kalon nga intimiteti i ndjenjës në refleksionin filozofik mbi qenien dhe kalueshmërinë. Stili poetik karakterizohet nga një gjuhë e përmbajtur, por e ngarkuar me emocion dhe metaforë të thellë. Vargu është i lirë, pa rimë të rregullt, por i ndërtuar me një muzikalitet të brendshëm që vjen nga ritmi i fjalës shqipe dhe nga ndjenja e sinqertë e shprehjes. Poeti nuk ndjek artificat formale të modernizmit ekstrem; përkundrazi, ruan një autenticitet gjuhësor e shpirtëror, ku çdo fjalë vjen si pjesë e një përvoje të jetuar. Në shumë raste, vargu i tij ngjan si një psherëtimë e menduar gjatë, një bashkëbisedim me vetveten, me kohën, me shoqërinë dhe me Zotin.

Poezia "Pikla nga qielli", titullin e së cilës e mban tërë vëllimi, është një tekst që ngërthen në vetvete ankthin kozmik, përsiatjen ekzistenciale dhe shpresën që rilind nga rrënojat e frikës. "Pikla nga qielli" është poezi e përballjes me kaosin, por edhe e besimit në ripërtëritje.

Ajo përmbledh frymën e të gjithë vëllimit poetik: përmes errësirës kalon rrezja, përmes frikës lind buzëqeshja, përmes dhimbjes vjen drita e kuptimit. Në vetëm pak vargje, autori arrin të krijojë një hapësirë filozofike ku përplasen dritë e errësirë, frikë e rilindje, qiell e tokë, pra, vetë përmasat e qenies njerëzore. Ajo hapet me një imazh të gjerë e tronditës:

"Një re e zezë n' hapësirë
Sillet në boshtin e rrëmujave…"

Kjo re e zezë është më shumë se një fenomen meteorologjik: është simbol i turbullirës së brendshme, i ankthit universal që mbulon ekzistencën njerëzore. Lëvizja "në boshtin e rrëmujave" është përkufizimi poetik i asaj gjendjeje ku njeriu ndjen se bota ka humbur qendrën e saj. Kjo metaforë kujton idenë e Heraklitit, filozofit të lashtë që thoshte: "Gjithçka rrjedh, gjithçka përplaset në një luftë të përhershme kundërshtish." Pikërisht ky tension mes të kundërtash është zemra e poezisë.

"Në planetin tokë dridhet frika
Pikla nga qielli vijnë, re të zeza..."

Në këtë varg ndodh ulja nga kozmosi në realitetin tokësor, nga dimensioni metafizik në psikologjinë njerëzore. "Piklat nga qielli" janë si rrjedhje e dhimbjes, si përthithje e trishtimit hyjnor në botën njerëzore. Frika që "dridhet" në tokë është përkthimi poetik i pasigurisë njerëzore përballë të panjohurës, një temë që përputhet me filozofinë ekzistenciale të Martin Heidegger, i cili e përkufizonte "ankthin" si mënyrën e njeriut për të ndjerë zbrazëtinë e qenies. Reja e zezë, në këtë mënyrë, është si projeksion i shpirtit njerëzor në qiell, dhe piklat që bien janë kthimi i dhimbjes në tokë, në vetëdije.

Poezia është e mbushur me simbolikë natyrore, re, diell, mjegulla, hënë… që nuk janë zbukurime, por personifikime të gjendjes së brendshme.

Kur poeti shkruan:

"Fjalëboshet i fsheh hëna
N'horizont shëtisin mjegullat…",

Këtu hëna, mjegulla e fjalët bosh marrin rolin e figurave mendore. Hëna "fsheh" fjalët e kota, si për të thënë që heshtja ka më shumë vlerë se zhurma, se në epokën e rrëmujës (si boshti i fillimit) kuptimi humbet, ndërsa drita (hëna) ruan vetëm thelbin. Ky moment ka një jehonë platonike, sepse përmes pastrimit të fjalës, njeriu afrohet te e vërteta e brendshme.

Në gjysmën e dytë të poezisë, errësira nis të zbutet:

"Rrezet e diellit ndriçojnë ëndrrat
Ripërtërihet buzëqeshja e vrarë"

Ky kalim nga errësira te drita është metamorfoza poetike që tregon se çdo pikë dhimbjeje mbart në vetvete mundësinë e shëlbimit. "Buzëqeshja e vrarë" nuk është vetëm imazh i dhimbshëm, por shenjë e rilindjes: një ndjenjë që ka kaluar nëpër vdekje, por që përsëri ringjallet. Në këtë pikë, poezia kujton filozofinë e Nietzsches, sidomos idenë e "Eternal Return", ringjallja e jetës përmes vetë shkatërrimit të saj. Drita që rikthehet nuk është ajo naive e fillimit, por një dritë e pastruar nga vuajtja.

Përsëritja e vargut final: "Pikla nga qielli vijnë pandarë...", krijon një efekt ciklik, një përmbyllje që nuk mbyll, por vazhdon. Kjo është metafora e përhershme e jetës: edhe pas frikës, rrënojës dhe rrëmujës, piklat (si dritë, si shpresë, si kujtesë) bien pa pushim.

Në të gjithë vëllimin, poezitë ndahen dukshëm në dy rrafshe:

Rrafshi intim e emocional, ku njeriu përballet me vetveten, me kujtimet dhe humbjet.

Rrafshi filozofik e shoqëror, ku poeti vëren botën përreth, absurditetin dhe zbrazëtinë e saj.

Në shumë poezi ("Frymëzim nate me hënë", "Dallgë të vetmuara"), nata shfaqet si simbol i heshtjes, por edhe i ndërgjegjes. Hëna bëhet një "bashkëbiseduese" e poetit, një sy që ndriçon plagët e shpirtit. Kjo e afron autorin me filozofinë e ekzistencës. Søren Kierkegaard e shihte vetminë dhe ankthin si mënyra të thella të komunikimit me Zotin dhe me thelbin e vetes.

Kur poeti thotë: "Hap sytë / Buzëqeshje e ngrirë në dritare...", ai përballet me dritën si me një pasqyrë të vetes, ku njeriu sheh jo jashtë, por brenda ndriçimit të vetmuar.

Në "E tash, çfarë bëj" dhe "Në pritje", dhimbja nuk është thjesht ndjenjë, por mënyrë e të qenit. Varësi të tilla si: "Ëndrrave të natës u vjen era plagë"; "Kujtimet mbajnë lotët si në epruvetë", shpalosin një estetikë të përkorë, ku kujtimi bëhet eksperiment, ndjenjat shndërrohen në substanca që digjen në laboratorin e shpirtit. Kjo të kujton Albert Camus dhe nocionin e absurdit, ku njeriu vazhdon të jetojë dhe të dashurojë edhe pse kupton kotësinë e ekzistencës.

Në "Sikur të isha", poeti nuk i ikën dhimbjes, por kërkon ta kthejë në dhuratë, të bëhet "thërrmi buke" për harabelat. Me këto ndjesi sakrifice dhe përulësie, autori e shndërron poezinë në një formë morali poetik, ku dashuria për jetën manifestohet përmes mëshirës.

"Dyzen krismash festimeve" dhe "Krismë që nuk ndalet" janë poezi protestuese në heshtje, që përçojnë neverinë ndaj shthurjes së natës moderne, një realitet i ndotur, i zbrazët, ku "fishekzjarrët" zëvendësojnë gëzimin e shpirtit. Poeti refuzon, duke i kthyer shpinën dhimbjes dhe kotësisë ("Ecni, u fola këmbëve pas mesnatës / Dhimbjeve ua ktheva shpinën").

Në çdo poezi ndjehet një lëvizje: nga nata në dritë, nga dhimbja në pajtim, nga vetmia në mall. Ky udhëtim është metaforë e jetës, një rrugëtim drejt vetëdijes, që nuk mbaron as me vdekjen. Kur poeti shkruan: "Dashuria nuk vdes as nuk varroset / Por ato takohen mes vete ëndrrave", ai prek një përmasë metafizike të dashurisë, si tek Platoni: ajo është e pavdekshme sepse i përket sferës së ideve, jo trupit. Kështu, poezia shndërrohet në tempull kujtese dhe ringjalljeje.

Një veçori tjetër e stilit të Bezhanit është bashkimi i lirizmit intim me epikën morale. Në poezitë e tij, edhe përjetimet personale marrin dimensionin e një rrëfimi të përbashkët. Kur flet për dhimbjen e vet, ai flet edhe për dhimbjen e të tjerëve; kur përmend mallin për vendlindjen, ajo bëhet metaforë e mallit për atdheun; kur përshkruan vetminë, ajo është vetmia e njeriut bashkëkohor që kërkon kuptim në një botë të shurdhët. Kështu, poezia e tij nuk mbyllet në individualitet, por shpërthen drejt universalitetit të ndjenjës njerëzore.

Poezia "Meditim malor" mund të konsiderohet peizazh i pasqyrimit të shpirtit. Kjo poezi është ndërtuar mbi një paralelizëm të bukur mes natyrës dhe vetmisë njerëzore. Peizazhi malor nuk është vetëm një hapësirë gjeografike, por një hapësirë shpirtërore, ku poeti gjen strehë nga lodhja e jetës dhe nga

"hatërmbetjet" e njerëzve.

"Aty te Blini", një himn për poetin Sejdi Berisha, por edhe për miqësinë dhe trashëgiminë poetike. Në këtë poezi, kafeja e mëngjesit, Lumbardhi dhe bisedat e poetëve marrin dimension ritualik. Ato janë si liturgji e shpirtrave krijues që lënë gjurmë përtej vdekjes.

"Mbante në dorë një fletë të bardhë e lapsin e zi
Radhiteshin fjalët, shkruante poezi
Për njerëzimin e kohët nxira moteve..."

Këtu poeti përshkruan misionin moral të vargut, qëndresën përballë kohës dhe vuajtjes. Ndërhyrja e gjallë e figurave reale (Lala, Nekiu, Luli) i jep tekstit autenticitet emocional, pra një dokument poetik i miqësisë dhe frymës krijuese. Kur Sejdiu thotë se, do ta hedhë stilolapsin në Lumbardhë, ajo bëhet metaforë e pavdekësisë së artit, lapsi që tretet në ujë, por pështpërit vargje përgjithmonë. Në këtë gjest ndjehet diçka simbolike si tek poezia e romantikëve evropianë, ku arti bashkohet me natyrën për të ruajtur kujtesën njerëzore. Ky tekst është në thelb një elegji e gëzueshme, një poezi për jetën, dashurinë ndaj atdheut dhe nderimin ndaj shokëve që ndajnë të njëjtin ideal poetik.

"Lot malli për gurin" trajton frymën e nostalgjisë për vendlindjen dhe për rrënjët e djegura të kujtesës.

"Kur ika
e lashë të gjallë kullën,
me dhimbje nëpër eshtra përplasej..."

Kulla, simbol i trashëgimisë, qëndresës dhe dinjitetit shqiptar, këtu është një organ i gjallë, që ndien, vuan dhe hesht. Ajo nuk është vetëm ndërtim arkitektonik, por vetë zemra e kujtesës kombëtare, e rrënuar nga lufta e koha. Kur poeti i puth "gurtë e çarë" dhe i shtrydh "lotët nga palca e zjarrit", ai kryen një rit të përkujtimit, një akt sakral: kthimi te guri, te dheu, te identiteti. Përmes "lotit" që rrjedh rrugës, poeti e shndërron mallin në udhëtim shpirtëror, në vazhdimësi mes të ikurit dhe kthimit.

Në planin filozofik, kjo poezi lidhet me konceptin hegelian të "pajtimit me realitetin": njeriu pajtohet me humbjen vetëm përmes njohjes së saj, përmes kujtimit aktiv që bëhet dashuri.

"Vargu im vrapon e vrapon" dhe "Vuajtja e ka heshtjen e gjatë" janë dy pole të një bote poetike të përbashkët: në të parën sundon lëvizja, përpjekja dhe sfida e fjalës poetike, ndërsa në të dytën mbretëron qetësia e dhimbjes, pesha e përmbajtur e vuajtjes njerëzore.

Në këtë mënyrë, të dy tekstet krijojnë një binom poetik që përmbledh gjithë filozofinë krijuese të autorit: poezia si rrugëtim përmes vuajtjes, dhe heshtja si forma më e lartë e ndjeshmërisë.

Poeti sjell me qetësi dhe përmbajtje realitetin e birucës, por pa rënë në rrëfim sentimental, përkundrazi, në atë hapësirë të errët, lind drita e shpirtit. "Përfytyrim në dhomën e burgut" është poezi e përmasave dokumentare dhe metafizike. Figura e "bylbylit që hyn në fluturim" dhe "gijotina që i vjen era liri" janë kontraste poetike të fuqishme: vdekja dhe liria, trupi i mbyllur dhe shpirti që frymon. Në këtë poezi, burgimi shndërrohet në laborator të lirisë, ku poeti përjeton thellësinë e shpirtit njerëzor.

"Kollitjet e natës" është një poezi e ndjeshme dhe alegorike. Kollitja, një veprim biologjik i trupit, kthehet në simbol të shpirtit që reagon ndaj plagës së qytetit, ndaj historisë së vet. Kollitjet janë si "tinguj lyrash të shpirtit", një figurë e jashtëzakonshme që bashkon dhimbjen me artin. Nëpërmjet ecjes nëpër rrugët e qytetit, poeti gjen gjurmët e lirisë së humbur, ku gjithçka rreh me kujtesë: kalldrëmet, pemët, dritat e neonit. Në fund, fjala "Liri" është kulm poetik jo si slogan, por si frymë që del nga dhembja e trupit kolektiv.

"Numërim i gabuar" është një poezi e shkurtër, por me një forcë filozofike të madhe. Në pak vargje, poeti përmbledh paradoksin e jetës dhe kohës: siç rritemi, koha përmbyset nga llogaritja e ditëve drejt ndjesisë se vitet janë bërë më të shkurtër se ditët. "Numëratorja e jetës ka ndryshuar". Kjo është metafora e krizës së perceptimit të kohës që vjen nga lodhja, nga kalimi nëpër dhimbje, nga lodhja e aritmetikës së jetës. Ky tekst minimalist është një haiku filozofik shqiptar ku përmblidhet në pesë rreshta i gjithë absurdi i përvojës njerëzore.

Një poezi e kujtesës dhe mallëngjimit, me ton elegjiak është "Isha dje aty". Kthimi "aty": te dera, gurët, kullat e djegura është kthim në identitetin e humbur dhe kujtesën e përbashkët kombëtare. Poezia përshkohet nga një ndjesi e thellë fiziologjike e mallit: poeti prek gurin, nuhat erën e shkrumbit, përjeton trupërisht dhimbjen e vendlindjes. Imazhi i moshatarëve "nën hijen e blirëve që pushojnë" është një përmendore e qetë, ku vdekja përzihet me përjetësinë e natyrës. Në tërësi, kjo poezi është një himn i heshtur për kujtesën, një rikthim që shëron përmes përulësisë.

"Natën në skenë", një nga poezitë më metaforike e introspektive të ciklit. Këtu poeti nuk flet më si dëshmitar, por si aktor në skenën e jetës, një metateatër poetik, ku jeta dhe arti përzihen. "Tekstin e kam në shpirt / por rolin akoma nuk e luaj" është një nga vargjet më të thella të gjithë ciklit: njeriu e njeh kuptimin e jetës, por nuk e jeton dot plotësisht. Në fund, "ranë perdet / duartrokitjet e fundit" është një fund ekzistencial ku jeta përfundon si shfaqje, dhe duartrokitjet nuk janë më lavdi, por psherëtimë përfundimtare.

"Heshtje e ndryshur" ndërtohet mbi tensionin midis forcës dhe durimit. Në të, heshtja nuk është zbrazëti, por energji e përmbajtur, si ujë që vlon nën gur. Vargu: "Mullinjtë e erës sillen në boshtin e vet", është simbol i mendimit që përsëritet, i kohës që s'ndryshon, i njeriut që qëndron. Në vargun kulmor: "Sa e hijshme bëhet jeta. Kur vaji pëlcet nga durimi i stepur..." poeti arrin një moment katarsisi poetik: dhimbja, kur përmbahet gjatë, lind bukuri, një filozofi stoike që përshkon gjithë poezinë e tij. Kjo poezi është qetësi e stuhishme, një lutje e brendshme që flet me zërin e heshtjes.

"Psherëtimë bjeshke, hapekrah në Shkrel" dhe "E ndiej zërin tënd edhe n' ëndërr" përfaqësojnë dy pole të ndjeshmërisë poetike të autorit: njerën e rrënjosur në tokë e atdhe, dhe tjetrën të ngjitur në qiell e dashuri. Në to, poeti është njëkohësisht dëshmitar i kujtesës dhe i shpirtit, duke i përzier me mjeshtëri topografinë fizike me peizazhin e brendshëm.

Më poshtë, një vështrim kritik për secilën poezi dhe një sintezë interpretative për të dyja bashkë. "Psherëtimë …" është një himn i heshtur për vendlindjen, një lirikë që bashkon frymën e natyrës me mallin për njeriun e shpirtit poetik.

Shkrel, Boga dhe Rugova nuk janë thjesht toponime. Ato bëhen simbol i qëndresës, i dhimbjes dhe i përjetësisë shqiptare.

"Shpirti ka shtrirë krahët majave të Shkrelit". Ky varg e hap poezinë me një figurë të fuqishme panteiste: shpirti nuk është më i kufizuar në trup, por shtrihet në natyrë, përthith hapësirën si frymë e lirë. Poeti e ndien vendin si pjesë të qenies së vet, një ndjesi që i ngjan konceptit të "unit kozmo-poetik" të Rilindasve. Figura e Azemit, që "shëtit zemrës sime pandarë", është personifikim i kujtesës poetike ndaj Azem Shkreli, figurë e madhe e poezisë moderne shqipe.

Poeti e sheh atë si "lapidar vetullave të zbardhura", një monument i shpirtit që s'e zbeh koha. Këtu, poezia bëhet përkulje përpara artit dhe frymës krijuese, një dialog shpirtëror mes poetëve dhe brezave. "Rugovë moj / Bukuri e dhimbje të shkrira së bashku" përmbyll poezinë si një dyzim ekzistencial: as bukuria, as dhimbja nuk mund të qëndrojnë më vete. Ato janë thelbi i një shpirti që ka kaluar nëpër stuhitë e kohës. Në këtë poezi, poeti është një hibrid mes peizazhit dhe kujtesës, një shpirt që flet përmes natyrës dhe vendit.

"E ndjej zërin tënd…" është e butë, e ndjeshme, e tejmbushur me mall dashurie, ku kujtimi merr trajtën e pranisë shpirtërore. Ajo që në dukje është një dialog intim, në thelb është një bashkëbisedim me të përtejmen, një lloj lutjeje poetike që kapërcen kufijtë e jetës.

"E ndiej zërin tënd të harlisur
Si violinë e çakorduar, këputur kohësh"

Këtu, poeti i jep zë mungesës. Zëri i dashur është një tingull që përshkon kohën dhe ndërron dimensionin e realitetit. Violina e çakorduar është një metaforë e përkryer për dashurinë që ka humbur harmoninë, por që ende dridhet, ende tingëllon. Në gjithë poezinë, ndjenja është e përmbajtur, por e thellë. Ai ndien "prekjen e duarve tua", "përplasjen e buzëve", "lutjen e zjarrtë", e megjithatë, gjithçka ndodh në ëndërr, në kujtesë, në frymë, jo në realitet. Përmes këtij përjetimi, poeti ngjitet drejt një dimensioni metafizik, ku dashuria bëhet amshim:

"Jetoi e iku si e paparë
në flakën e dashurisë së përmotshme
shkëndija do bëhemi një ditë
si një lapidar..."

Ky fund është monumental: dashuria njerëzore ngjitet në nivel simbolik, si një "lapidar", pra si dëshmi që nuk shuhet. Kjo metaforë e bashkon dashurinë me kujtesën, shpirtin me përjetësinë, një frymë që ngjan me konceptin platonik të dashurisë si formë e përhershme, që s'vdes, por ndryshon formë.

"Përplasje me vargun" shpalos procesin e krijimit si betejë. Poeti përballet me fjalën, jo si mjeshtër i saj, por si robtar dhe luftëtar brenda saj. Vargu këtu merr formën e një qenieje të gjallë, të egër, të pakontrollueshme: "Përplasje, grindje me vargun e tërbuar".

Referenca "Ah! Khajam!" e lidh poetin me traditën filozofike të Omar Khajamit, një vetëdije që pyet për kuptimin e jetës, për kotësinë e kohës, por edhe për dehjen e fjalës. Kjo poezi është një metapoetikë, një reflektim mbi vetë aktin e krijimit si dhimbje, si nevojë, si mallkim.

Një nga poezitë më të buta e më nostalgjike të ciklit është "Kitara ime e vjetër". Kitarja është simbol i artit që plaket bashkë me njeriun, por që ruan shpirtin e dikurshëm të dashurisë e këngës.

"Kënga pëlciste me zjarrin e pashuar / E zemra mbushej dashuri…" Tani, ajo është "statujë muzeale", "e ndryshkur", por telat ende "dridhen përmallshëm". Kjo poezi e lidh ndjenjën e artit me kalbjen e kohës por edhe me përjetësinë e kujtesës. Në fund, buza që dridhet është metafora e poetit vetë: një krijues që e ka këngën të gjallë, edhe kur zëri është shuar.

"Trazim", një poezi me ton sociopolitik e filozofik, ku poeti del nga vetmia për të parë botën si arenë padrejtësish.

"Kjo botë përkundet në anije pa timonier"

Një figurë e fuqishme përshkruan kohën moderne, pa drejtim moral, pa busull shpirtërore. Të varfërit, pushtetarët, grabitja e "një kore buke", janë motive migjeniane, por me një dritë më të zymtë: këtu shpresa është e mekur dhe "shpirti dridhet meridianëve". Poezia është akt ndërgjegjeje, një "trazim shpirti në kohë trazirash".

"Lisi i moçëm", një poemë e kujtesës dhe e identitetit. Lisi është simbol i fëmijërisë, i rrënjëve, i qëndresës, por edhe i kalimit të kohës.

"Koha ia kishte tharë degët, lëkura i ishte plasaritur…" Lisi dhe poeti janë moshatarë, të dy të plakur, të dy dëshmitarë të stuhive. Zogjtë që kanë bërë çerdhe në trungun e çarë sjellin një ndjesi ciklike: jeta vazhdon edhe mbi rrënoja. Në fund, poeti shndërrohet në "endacak rrugëve", por me zjarre të brendshme që s'shuhen, metaforë për shpirtin që nuk gjen prehje larg origjinës.

Një poezi kontemplative dhe vizuale është ajo me titull "Në dritare". Dritarja bëhet portë drejt botës dhe vetvetes.

"Vetmia e dhomës më tërheq për flokun e thinjur"

Një imazh i jashtëzakonshëm: vetmia ka dorë, ka fuqi fizike, të "tërheq" drejt saj. Pamjet e jashtme: horizonti, era, drita e hënës… janë pasqyrë e brendshme e shpirtit që vuan, pret, kujton. "Vitet e shkuara, një poezi retrospektive, ku koha merr trup e frymë.

"Në fletoren shumëfaqëshe të jetës / Janë drynuar kujtime të thella"

Kujtesa është si një arkiv që as "era, as furtuna" s'e fshin. Në këtë poezi bie në sy qëndrueshmëria morale dhe shpirtërore: edhe kur "shtrembëroheshin lisat, rrënjët nuk tundeshin". Një metaforë e bukur e brezit që qëndron, edhe kur gjithçka tjetër thyhet.

Këtu poetit i mbetet vetëm dhimbja dhe dashuria si relikte të përjetshme, pra një filozofi stoike dhe e thellë.

"Një gotë verë", një poezi e jashtëzakonshme për vetminë dhe solidaritetin njerëzor, e cila fillon me një ton ekzistencialist: "Në shtrat prej zhguni klithmat zhurmojnë", por pastaj zbutet në një përqafim njerëzor me "fukaranë" dhe "dy qentë" që ndajnë bukën. Në fund, gota e verës është metafora e dia-

Kanuni i Lekë Dukagjinit, gur themeli i ndërtimit të shtetit vetëqeverisës në Shqipërinë e Epërme

Mirdita, si pjesë territoriale e Shqipërisë, është treva që e ka vetudhëhequr veten. Kjo është diktuar nga arsye të ndryshme në luftë të ashpër me izolimin dhe barbarinë skllavëruese. Kjo trevë del në evidencë pikërisht gjatë sundimit turk nëpërmjet gatishmërisë për qëndresë. Albanologu i shquar gjerman Peter Bartël thekson se; "Mirdita prej kohësh kishte një qeveri autonome që nuk u cenua dot as nga zaptuesit turq. Shoqëria e kanunit ka prejardhje patriarkale, nëse ligjet e sotme janë të mangëta, atëherë e vjetra ngre krye", -vijon ai".[1] Faktorët kryesorë dhe baza themelore e kësaj vetëqeverisjeje autonome është e drejta tradicionale e saktësuar dhe sanksionuar në "Kanunin e Lekë Dukagjinit", i cili, sidomos për të huajt, është një shenjë e fortë identifikimi dhe identiteti.

"Po të studiohet me kujdes Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe veçanërisht kapitujt mbi fiset dhe ndarjet e tyre, mbi pronën, familjen, martesën dhe trashëgiminë, -ka shkruar Nopça, -do të shohim në realitetin shqiptar, gjurmët e lashtësisë". [2]

I të njëjtit mendim është edhe Painsippi kur shprehet se: "Trualli i malësorëve shqiptarë ka qenë deri në vitet 1947 dhe deri në këtë kohë në mënyrë vërtetë absolute, një ishull i izoluar i drejtësisë së lashtë, në epokën e re të drejtësisë evropiane". [3]

Nëse këtë të drejtë dokesore e shohim si themelin e mbijetesës, rrënjët e saj janë tej shekujve, madje deri në lashtësi.

E drejta tradicionale e pashkruajtur, ka qenë burimi kryesor i së drejtës derisa dolën ligjet e shtetit. Kështu ka ndodhur në Egjipt, në Babiloni, në kodin e Hammurabit, apo në Hindi me kodin Manu, në Greqinë e Vjetër me ligjet e Solomonit e të Drakonit, në Romën e Vjetër me 12

---

logut me kujtimin, me miqtë e vdekur, me vetveten. Poezia përfundon me një imazh që shkrin trishtim dhe madhështi: "Gota e verës ishte mikja ime e pandarë", një akt fatalist, por edhe fisnik. "Shëtitje" sjell një mbyllje të qetë, gati testamentare. Poeti ecën ngadalë, "me shkopin, mikun tim", një figurë që përçon dinjitet dhe përulësi para kohës. Smolica, "Itaka ime", është kthimi simbolik në origjinë. Poeti, si Odise që më në fund e pranon se udhëtimi i vërtetë është në kujtesë. Këtu, gjuha është e butë, fryma e përmbajtur; ka melankoli të urtë, por edhe pajtim me jetën. Në fund, gjithçka tretet në një "bardhësi kohe", një dritë që s'ka dhimbje, vetëm kujtim.

Sikurse vërehet, në çdo poezi ndihet një ton i përzier: dhimbje, revoltë, mall dhe qetësi. Autori shkruan me një gjuhë të pasur, me metafora që mbartin gravitet emocional e filozofik, duke ndërtuar një univers ku: fjala është zjarr, kujtesa është atdhe dhe shpirti është instrument që dridhet në heshtje. Nëse do të duhej ta përmblidhnim në një varg, këto krijime flasin për një të vërtetë të thjeshtë e të përjetshme: "Koha mund të rrudhet, por shpirti i poetit s'e humb dot këngën."

"Para pasqyrës në dhomën time" është një poezi introspektive që ndërton një raport simbolik midis poetit dhe pasqyrës si pasqyrim i shpirtit dhe i kohës së kaluar.

Pasqyra e thyer është metaforë e identitetit të copëtuar, e lodhjes shpirtërore, e pamundësisë për t'u njohur më me veten: "Nuk e njoha vetveten / Mes luginave të ballit frynte erë e nxehtë."

Në këtë tekst, pasqyra është "bashkëbiseduese", një lloj gjykatëse e heshtur e jetës së poetit. Në fund, fjalët "uri e shëmtuar është jeta" sintetizojnë ndjesinë e zbrazëtisë ekzistenciale. Kritikisht, kjo poezi i përket lirizmit modernist introspektiv, me ndikime të qarta nga poezia filozofike por me ton të thellë personal dhe gjuhë të figurshme shqipe.

Te "Ëndërr e bukur" poeti largohet nga realiteti përmes ëndrrës, duke krijuar një hapësirë metafizike të shpëtimit dhe dashurisë. Përmendja e Markezit dhe Octavio Paz-it e lidh këtë poezi me një univers letrar ndërkombëtar, duke treguar vetëdijen kulturore të autorit. Ëndrra bëhet ura midis jetës fizike dhe frymës poetike, aty ku dhimbja "shpërlahet", por dashuria mbetet e pavdekshme. Vargjet janë të lëngshme, të buta, me një ritëm meditative. Kjo poetikë e ndjesisë përfaqëson momentin kur poeti, përmes artit, gjen paqen që realiteti nuk ia jep dot.

Një poezi metapoetike është "Dialog me vargun", ku poeti hyn në dialog me krijimin e vet, pra me vetë artin. Vargu është i gjallë, i padëgjueshëm, i egër, simbol i frymës krijuese që e ndjek dhe e lodh poetin:

"Ti, vargu im idhnak / Kurrë nuk më le të qetë."

Ky motiv kujton polemikën e poetit me muzën, një traditë e vjetër që në antikitet. Në thelb, poeti kërkon lirinë shpirtërore përmes fjalës, por e gjen veten të robëruar prej saj. Ky "dialog" është në fakt një monolog shpirtëror i mbingarkuar emocionalisht, një përpjekje për ta humanizuar vetë poezinë si qenie që e gëzon dhe e mundon njëkohësisht.

Stilistikisht, teksti është i ritmuar, me figuracion të fortë, që e afron me simbolizmin poetik bashkëkohor.

Një poezi testament: "Kur të vdes", e përulët, por krenare; e dhimbshme, por e pajtuar. Poeti përballon temën e vdekjes me një realizëm të ndritshëm, pa frikë, pa patetikë.

"Kur të vdes / Do jetë ditë me diell..."

Ky hap i parë çmonton klishetë e vajtimit: vdekja shihet si pjesë e natyrës, jo si tragjedi. Kërkesa "mos ejani të pispillosur, me kollare" është një akt i rebelimit estetik dhe moral, një përzgjedhje etike e poetit për autenticitetin. Në fund, figura e "skamnorëve" është epitaf i ndershmërisë poetike, solidaritet i hapur me njeriun e thjeshtë, me ata që "dinë të lexojnë letrën e jetës". Kjo poezi është një trilogi e shpirtit në tre akte: njohja me veten, ballafaqimi me artin dhe pajtimi me fundin. Në tërësi, ajo dëshmon pjekuri estetike dhe mendimtare, duke u bërë një lloj ditari poetik i ndërgjegjes njerëzore.

"Zëri i kullës së djegur" është një poezi monumentale, që rishfaq një nga simbolet më të njohura të kulturës shqiptare: kulla si vatër, kujtesë, identitet dhe qëndresë. Kulla e djegur është metaforë e atdheut të plagosur, por edhe e shpirtit të poetit. Ajo flet, digjet, kujton, por mbetet "me zë lirie". Në vargjet e para, poeti e ngre kujtesën personale në nivel kombëtar:

"Më bëhet se dëgjoj thekshëm / Rraptimën e djepit ku përkundej rrita ime..."

Ky rikthim te djepi, në prehrin e nënës dhe në "odën e burrave", shndërrohet në një udhëtim në rrënjët shpirtërore të shqiptarësisë. Në pjesën e dytë, toni bëhet elegjiak e njëherësh krenar. Kulla nuk është vetëm rrënojë fizike, por tempull i kujtimeve, i burrërisë dhe i besës. Edhe e djegur, ajo ruan zërin, shpirtin dhe kujtesën.

"Ke zë lirie, je emër krenarie / Histori e jetës sime nëpër flakë malli..."

Në fund, poeti i drejtohet kullës me një lutje pothuaj mistike:

"Në mos unë, shpirti im do vijë / Më le hapur derën ose një dritare!"

Ky varg është një testament shpirtëror: poeti kërkon pavdekësinë në kujtesën e vendit të vet, në simbolin e kullës që e ka lindur.

Kjo poezi është një ndërthurje mjeshtërore e epikes së kujtesës historike me lirizmin intim.

Struktura e saj na kujton baladat dhe legjendat shqiptare, por gjuha është e përpunuar, moderne, me një ndjesi sakrale e antropologjike. Mund ta konsideroj si poezi autobiografike në formë dhe kombëtare në përmbajtje, ku përvëlimi personal bëhet kujtesë kolektive.

Poezia "Nuk kam adresë", në dukje më e heshtur, e gjen poetin që tashmë është "në udhëtim", pa adresë, mes botës së jetës dhe asaj të kujtesës. Adresën e humbur nuk duhet ta lexojmë si mungesë banese, por si shenjë e kalimit drejt një bote tjetër shpirtërore, të përtejme, të qetë.

"Mos më dërgoni letra, as porosi / Nuk banoj në të njëjtën adresë..."

Këtu poeti është në dialog me miqtë, me kohën dhe me lexuesin. Ai tashmë nuk i përket më botës së përditshme, por mbetet i pranishëm në fjalë, në kujtim, në varg.

"Në varg dua të jam i varur kujtim / Në adresën e dhimbjes sime..."

Në këtë poezi, ndjenja e vetmisë është e gërshetuar me pranimin e qetë të moshës dhe të rrugës drejt amshimit. Shkopi që mban në dorë, shikimi që venitet, janë shenja të njeriut që e njeh fundin, por nuk dorëzohet para tij.

"Nuk dëshiroj të tretem, pa dëshmi...". Ky varg është thelbi i gjithë poezisë së tij: dëshira për të mbetur dëshmi, për t'u kujtuar përmes artit, përmes poezisë.

Krijimtaria e autorit Tahir Bezhani, në aspektin emocional, përshkohet nga një ton i përhershëm meditativ e elegjiak. Dhimbja, kujtimi, malli dhe heshtja janë katër kolonat mbi të cilat ngrihet struktura e tij poetike. Në to ndihen gjurmët e një shpirti që ka parë shumë, ka përjetuar shumë, por ende beson te fjala, te bukuria, te shpresa. Edhe kur shfaqet pesimist, ai mbetet një pesimizëm fisnik, i mbështjellë me ndjesi të thella humane. Poezitë "Kur të vdes", "Nuk kam adresë" apo "Vuajtja e ka heshtjen e gjatë" tregojnë se poeti e sheh vdekjen jo si fund, por si vazhdim i qetë i një udhëtimi shpirtëror, ku fjala poetike është dëshmi e pavdekësisë.

Në planin estetik, poeti e ka ndërtuar stilin e vet përmes një gjuhe të ngrohtë, metaforike dhe të kristaltë. Ai përdor imazhe të natyrës për të shprehur ndjenja të brendshme: retë, shiu, dielli, malet, era, dritarja apo pasqyra bëhen pasqyrim i lëvizjeve të shpirtit. Vargu shpesh është i gjatë, i valëzuar, si frymëmarrje e lodhur, por e qëndrueshme, një stil që e dallon qartë nga shumë bashkëkohës të tij.

Në përmbledhje, mund të thuhet se autori ka krijuar një poetikë të qëndresës, kujtesës dhe humanizmit. Ai është poet i njeriut të thjeshtë, i tokës dhe i shpirtit që digjet, por nuk shuhet. Përmes një gjuhe të kthjellët e ndjenjash të thella, ai e ka bërë poezinë dëshmitare të kohës dhe strehë të shpirtit njerëzor. Në librin "Pikla nga qielli", kjo pjekuri arrin kulmin: fjala bëhet më e qetë, më e thellë, më e urtë. Poezia e tij është, në fund të fundit, testament shpirtëror i një jete të tërë, që flet për dashurinë ndaj jetës, ndaj njerëzve dhe ndaj fjalës që mbetet përjetësisht bashkë me artin.

***Gjakovë, 05.11.2025**

tabelat, si dhe gjatë Mesjetës me shumë ligje të tjera.

Mendimtarë të ndryshëm, duke filluar nga Aristoteli, juristët e Romës së vjetër e deri te Hegli e kanë quajtur të drejtën tradicionale "të drejtë të pashkruar".

Dihet se në shtetet ilire, shtetin e Arbërit, në shtetin e Gjergj Kastriotit e në vijimësi, e drejta tradicionale shqiptare e pashkruar ka qenë burimi kryesor i të drejtës.

"Kanuni i Lekë Dukagjinit" për shumë shekuj u kthye në mit e ai mori forcë të madhe vepruese sidomos në shekullin XVI, kur qytetet shqiptare u shkatërruan nga themelet.

Organizimi i Mirditës në unitetin e 12 krahinave me kapedanin në krye, shtëpia e Gjomarkajve, qe shpallur "Themeli i Kanunit". (4)

Mirdita, "Kanunin e Lekë Dukagjinit" e ka bazën e vet themeltare të mbijetesës dhe të vetëqeverisjes, edhe pse ligjet e tij, si e drejtë tradicionale për shekuj, mbetën "të drejta të pashkruara" derisa kanuni u mblodh nga Shtjefën Konstandin Gjeçovi, në Gomsiqe të Mirditës dhe u botua si vepër më vete, rreptësishtë e strukturuar, në vitin 1933.

Kjo e drejtë tradicionale jetoi gjatë e pashkruar si rregullator i marrëdhënieve shoqërore për disa arsye:

- Për shumë shekuj jetuan marrëdhëniet patriarkale fisnore.
- Ekzistonte organizmi vetëqeverisës posaçërisht në Mirditë.
- Pushtimi i gjatë osman pengoi formimin e shtetit të pavarur shqiptar.
- Ekzistonte një prapambetje e madhe në shkollim.
- Zotëronte mentaliteti i fuqishëm për të jetuar si të parët tanë, e të tjerë.

Mbrojtja e kësaj të drejte zakonore kontribuonte në mbrojtjen e autonomisë vendore të Mirditës, po ashtu ruajtja e së drejtës tradicionale ishte dhe pjesë përbërëse e vetëdijes kombëtare. Kanuni u ngjiz në Mirditë, si epiqendër e tij. "Ai vetë është një minierë e tërë mahnitëse e gjenisë njerëzore me emrin e së drejtës". Edhe kur është tepruar, qëllimi ka qenë vetëm përpjekja për të realizuar drejtësi. Prandaj është cilësuar i shenjtë.

"Pa dyshim, - thekson Prof. Ismet Elezi, merita kryesore u takon mirditasve, të cilët ruajtën në kujtesën e tyre normat e së drejtës tradicionale bashkë me autonominë vendore. Ndërkaq duhet vënë në dukje fakti se Kanuni i Lekë Dukagjinit është burimi kryesor i së drejtës tradicionale shqiptare".(5)

Ndërsa Tonin Çobani shkruan: "Larg garnizoneve ushtarake dhe institucioneve të imponuara, shqiptarët do të ruanin lirinë e tyre, besimin e tyre, gjuhën dhe kulturën e tyre, ligjet e tyre". (6)

"Kanuni i Lekë Dukagjinit", ose "Kanuni i Maleve", quhet i tillë pse veprimtarinë e tij dhe zbatimi i tij bëhej në malet e Veriut të Shqipërisë. "Nëpër male e nëpër luginat malsorët çojnë një jetë të thjeshtë ku sundon i Pari i Shtëpisë; kjo jetë ka faqe trimnije dhe shihje të Homerit, sikur kangë të kreshnikëve".(7)

Ligjet e "Kanunit të Lekë Dukagjinit," sipas VValther Painsippit, rrjedhin nga vendimet "ligjore" të marra në Kuvendet e Përgjithshme të fiseve dhe të bajraktarëve. (8)

Karakteristika themelore e Kanunit është se parimet (nderi, besa, mikpritja, burrëria e të tjera.) dhe institucionet kryesore të organizimit shoqëror, (familja, prona trashëgimia, ligjet e pëlqeve e të tjera) përbëjnë dhe shtyllat kryesore të tij. "… Ndër Malësorët kishte fuqi ligji i rreptë i maleve, "Kanuni i Lekë Dukagjinit…." --thekson Painsippi

Traditat shqiptare, sa të egra ndaj së keqes, aq edhe njerëzore ndaj së mirës, rekomandojnë: "Hasmi fisnik gjithmonë i shmanget familjes së viktimës dhe rrethit të saj, me qëllim që të mos i rëndojë ende më shumë. Madje shkon edhe më tej: për t'i nderue sa më shumë, dhe u përulet duke iu çue njerëz të mirë e burra të urtë për t'u ba lutje për falje! Ndërsa hasmi burrë (e ky gjest fisnik veçse ia rrit vlerën!); dhe rrethi dhe familja e viktimës, burrnisë së hasmit burrë i përgjigjen me të njëjtën monedhë I vret përulja fisnike e hasmit burrë dhe e falin." Edhe pse "gjaku lahet me gjak".

Le të arsyetojmë mbi fenomenin e gjakmarrjes. Gjeçovi e përcakton "gjakmarrjen si detyrim shoqëror". Por ne na takon të shtyhemi pak më tej: Pse ka rrjedhë ky detyrim shoqnor? Edhe përgjigjja është gati: Pse mungon shteti i së drejtës! Dhe pikërisht pse Shqipëria (pra kombi shqiptar) pesë shekujt e fundit ishte e pushtuar nga turqit, pra nuk kishte shtet të vetin të së drejtës lindi nevoja e një organizimi dhe funksionimi tjetër (dokesore) në fis, bajrak apo bashkim bajrakësh. Për këtë arsye Urtia shqiptare nxori nga gjiri i saj Kodin e së drejtës tradicionale, -KANUNIN, me anë të të cilit sheshoheshin mosmarrëveshjet, jepej drejtësia, bëhej bashkimi e organizohej mbrojtja e trevave shqiptare. Dihet se Shqipëria ka qenë e pushtuar nga pushtues mizorë. Kësisoj edhe e drejta Tradicionale, KANUNI, ka gjasë të jetë më shumë sesa civil, Kanun Ushtarak. Kësodore është e justifikueshme edhe ndonjë privim që bije ndesh me të "Drejtat e njeriut të sotëm."

"Ai, të cilit iu muar nderi, zihet i dekun nga kanuni". (9)

Kanuni i Lekë Dukagjinit është gjithsesi edhe ligji modern, i cili i jep rëndësi të veçantë mendimit dhe gjykimit të lirë. Është vendosur në ligj parimi "fjala mort s'bën", nga ana tjetër fjala ka peshë të jashtëzakonshme përderisa "beja lan gjaqe". E askurrkush nuk ka të drejtë ta dyshojë benë e bame që bëhet mbi kryqin e ungjillit.

Kanuni i maleve të Shqipërisë nuk e veçon njeriun prej njeriut, "Shpirt për shpirt se dukën e fal zoti." "I miri e i keqi kanë një çmim." "Del i miri prej të keqit e i keqi prej të mirit," sanksionohet në Kanun, po ashtu "Burri i fortë merr gjobën e vet." Pra Kanuni nuk dallon, nuk paragjykon, nuk mban krahun e askujt për shkak të pozitës, të racës, të fesë. Çdo njeri ndihet i barabartë në bashkësi, në kuvend, në shtëpi, në dasme e në mort.

Nderi, besa, mikpritja, burrëria kanë një vend të veçantë në Kanunin e Lekë Dukagjinit, ku ato përbëjnë shtylla të forta të tij dhe kjo më së miri, duket në pozitën krejt të favorizuar të mikut. Mbrojtja e tij kishte të bënte me mbrojtjen nga çdo lloj rreziku që mund t'i kanosej. "Shpia asht e zotit dhe e mikut!" gjithsesi kjo ka një kuptim të madh e shkon deri atje sa me u pre



miku në bukën e tjetrit, merrej gjak për të. Por nga ana tjetër miku duhej me u ndjerë si në shtëpinë e vet, pra duhej respektuar deri në maksimum, duke i bërë nderimet e nevojshme "bukë e kripë e zemër". E pra atij i lëshohej kryet e vendit si për nderim, si dhe ma në të pamë e në shenj, si edhe të mos përzihet ndër rob të shpisë". Miku nga ana e vet ka shumë rregulla, që nuk mund t'i shkelë. "Si t'i prish mikut, çdo dhunë t'i baje kuej, lypet mbi ty."

"Besa" është tradita më e shenjtë; kur njeriu ka besën e një personi të mirë të njërit fis, çnderimi më i madh pret fyesin e saj prej çdo personi të atij fisi. Besa shqiptare jo vetëm që mbahet dhe mbrohet me vullnetin më të mirë, por shqiptari po të jetë nevoja jep edhe jetën për të mbrojtur besën. Një udhëtar nën fjalën e besës është nën mbrojtje të shenjtë". (10)

Ndërkohë te Rose Lane përfytyrimi që u jep këtyre anëve është i tillë: "Më dukej sikur isha kthyer në një vend që e njihja prej kohësh dhe këtu e ndjeja vetën në vendin tim. Kisha harruar se këta njerëz ende jetonin fëmijërinë e racës ariane dhe se unë isha bij e një shekulli që, për ta, ishte në një të ardhme të largët e të panjohur. Për mua njëzet e pesë shekuj ishin zhdukur sikur të mos kishin qenë kurrë." (11)

Faik Konica shkruan "Standardi etik i shqiptarit është besa, pra, fjala e dhënë. Pavarësisht nga rrethanat, kur një shqiptar jep fjalën, ajo nuk mund të shkelet dhe nuk ka nevojë për asnjë lloj marrëveshjeje të shkruar." (12)

Gjergj Fishta shkruan:

"Gjak e vjamë, der' n'kupë të gjunit, / Bukë shqiptare mbas kanunit." (13)

E ky ligj i Lekë Dukagjinit bazohet te nderi personal, që është gjithmonë dhe nderi i fisit,

"Preki'i herë ti n'tokë të Parve, / Prki'i herë ti n'erz të fisit, / Edhe ty kan me t'diftue, / Se si dijnë këta me u bashkue". (14)

"Lart në ato male - pikërisht atje, në ato male, - shton studiuesja amerikane ROSE LANE, -njerëzit jetojnë sikurse jetonin njëzet shekuj më parë, kur grekët ose romakët, ose sllavët nuk njiheshin ende. Atje lart ka qytete parahistorike, legjenda, këngë, doke të vjetra dhe askush nuk di gjë për to. Në fakt, askush nuk ka qenë ndonjëherë atje". (16)

"Unë jam konservatore, madje dhe reaksionare. Unë do të doja t'i ruaja malet shqiptare kështu siç janë". (15)

Kanuni kurrsesi nuk është i barbarë. Burri i fortë merr gjobën e vet, –thuhet në Kanun, por kurrsesi Kanuni nuk lejon dhunimin dhe shëmtimin fizik, gjymtimin e organeve të njeriut, duarve, syve, fytyrës, etj. Krejt ndryshe ndodh me të drejtën bizantine.

"Ky popull, ashtu si dhe malësorët tonë në Austri deri para pak kohësh, nuk kishin nevojë për juristë e sisteme moderne juridike për ta përballuar jetën, për këtë arsye, për këtë popull me moral kaq të shëndoshë e të pastër nuk ishte e vështirë të mbante mend ligjet dhe normat, e përveç kësaj kujtesa e njerëzve që e përçojnë dijen vetëm gojarisht është tepër e zhvilluar". (16)

"Në studimet evropiane termi fis shpesh është përdorur për të grupuar popujt e lashtë". (17)

Kanuni shpesh është sulmuar edhe padrejtësisht. Bëhet e ditur se sipas statistikave të përafërta, konkludohet se mbi dy herë më shumë vrasje në vitet 1990-2000 janë kryer në Jug, atje ku kanuni nuk njihet fare! Madje vrasje makabre, të cilat kanuni i ndëshkon rreptë. Dhe kjo nuk ka ndodhur kurrsesi pse atje zbatohet kanuni. Por nga ana tjetër përderisa në Veri numri i vrasjeve është dy herë më i pakët kjo tregon se e Drejta Tradicionale në njëfarë mënyre po e kryen detyrën e vet. Së paku vrasje makabre nuk ka! Me keqardhje duhet pohuar se shpesh në medja çdo vrasje në Veri thirret si gjakmarrje. Një gjë është e padiskutueshme, që Kanuni është i rreptë për të gjithë njëlloj! Pa dallim! Edhe Kapidanin e Mirditës, që është thirre "Themel i Kanunit të Lekë Dukagjinit", e ka ndëshkuar.

Lind një pyetje: Pse shfaqet fenomeni

kanun?

Nëse ai shfaqet, kjo nuk vjen për faj të tij, por nga pazotësia e politikanëve të sotëm për të nxjerrë ligje fisnike, detyruese dhe zbatimin e tyre me përpikëri.

Nga ana tjetër shtyllat e vetëdijes njerëzore venë në themel të Kanunit familjen, pronën, trashëgiminë, ligjet e pëlqeve e të tjera.

Trajtimi i familjes në Kanun përcakton qartë pozitën e kësaj qelize bazë të shoqërisë, në vetvete, në lidhje me vllazninë, gjininë, fisin, flamurin e gjer kombin.

Detyrat e të zotit të shtëpisë përcaktohen qartë dhe prerazi. Këtu duket se mbahet parasysh fort një tregues, ai i të qenit kujdestar për të tjerët; natyrisht kihen parasysh mosha, por së pari mençuria, urtësia.

"I zoti i shtëpisë ka për detyrë kryesore me mbajte udhën e drejtësisë në shtëpi, e mos me majt krahun ma tepër njënit se tjetrit; me u ble armë djemve kur ta shohë se janë ba për to.

E njëjta gjë është edhe për të zonjën e shtëpisë, por kjo nuk do të thotë se pushteti i tyre është i pakufizuar; përkundrazi gjindja e shtëpisë ka të drejtë me i heqë nëse nuk punojnë për të mbarën e shtëpisë".

Kanuni e koncepton femrën si qenie të dobët, ndaj e sheh si njësoj inferioriteti, duke i dhënë një rol dytësor në raport me burrin. Doemos kemi këtu edhe njërën ndër pikët më të kontestueshme të Kanunit, por duhet pasur parasysh shkalla e emancipimit kulturor, niveli i shkollimit dhe zhvillimi shoqëror. Por edhe sot në mjaft qytetërime nuk është arritur barazia reale midis burrit dhe gruas.

Kanuni nuk mund të thuhet se e nëpërkëmb gruan, madje përkundrazi, Kanuni në mjaft raste e merr në mbrojtje, sidomos gruan e vejë. Femrën kurrsesi nuk e prek hakmarrja. Është veprim i turpshëm t'u shkaktosh një dëm apo t'i fyesh. "Ai që vret një grua detyrohet dy gjaqe". Kurrsesi gruaja nuk është e mbyllur. Ajo dilte në festa, shkonte në kishë e mjedise të tjera publike. Burri i blen mundin e të jetuemen grues, por jo jetën e saj.

Kanuni përcakton qartë edhe gjithçka që ka të bëjë me pronën, ujin, vijën, arën, livadhin, e të tjera.

Kanuni ngrihet kundër martesave pa kurorë, rrëmbimit të vajzave, e të tjera.

Për njerëzit që nuk njohin Kanunin apo thelbin e tij, shpesh ai njësohet me gjakmarrjen. Por ka edhe më keq kur mohuesit dhe aq më tepër denigruesit e tij, këtë dukuri e përdorin si argument për rrëzimin e tij. Në të vërtetë ky problem është shumë më i thellë sesa mohimi apo pohimi kategorik. Në fakt vetë kanuni paralajmëron "mos vra" dhe më pas përcakton vrasjen për gjak "Gjak për gjak". Normat kanunore vetë janë tepër të thella e të menduara, e kështu në këto norma është saktësuar dukshëm kërkesa e përsëritur për të falur gjakun. Kështu " Fjala mort nuk bën" e ardhur në të njëjtin nëntekst "goja s'qet kënd në gjak" apo "Çmimi i jetës është nji si për të mirin, për të keqin" Por duhet të kemi parasysh një gjë "po qiti pushkë prita mbi gra, fëmijë, shpi a mbi bagëti, punon kundra kanunit." Gjithashtu kanuni përcakton qartë se "vetëm dorasi bije në gjak" pra kjo e barasvlershme me shprehjen "Gjaku shkon për gisht". Nga marrja e gjakut përjashtohen gratë, fëmijët, prifti.

Sot ka një anomali të theksuar, ndërkohë, që nga elita kulturore, juridike kërkohet që kanuni të arkivohet si një monument historik i së drejtës, njerëz të malësive shqiptare nga ana tjetër pretendojnë se zbatojnë Kanunin në çështjet e pronësisë e gjer vetëgjyqësi.

Ky është realiteti objektiv i vendit tonë. Shqipëria qeveriset nga Kushtetuta dhe ligjet bashkëkohore demokratike. Nga ana tjetër veprojnë normat e së drejtës tradicionale në disa zona malore për zgjidhjen e çështjeve të caktuara. Me një fjalë duam apo nuk duam, objektivisht ekziston dualizmi juridik. Por ky është një fenomen kalimtar. Me forcimin e shtetit të së drejtës, me forcimin e ndërgjegjes juridike në shtresat e gjera të popullsisë, do të respektohet kushtetuta dhe ligji i shtetit, kurse zbatimi i kanunit do të bëhet i panevojshëm.

Natyrisht ky është një proces historik dhe nuk mund të realizohet ashtu siç duam ne, sepse aktualisht forcimi i autoritetit të shtetit, e të ligjit, lë shumë për të dëshiruar. Por, një gjë dihet me siguri, se e ardhmja iu takon ligjeve demokratike për rregullimin e marrëdhënieve shoqërore në të gjitha fushat e jetës. Kanunet do të vlerësohen si monumente të kulturës popullore në tërësi, dhe asaj juridike në veçanti, për të cilën Mirdita ka merita të mëdha historike.

Le të shohim, me vëmendje dhjetëvjetëshin e fundit.

Gjatë këtyre dhjetë-katërmbëdhjetë vjetëve të fundit, kur në disa zona të Malësisë së Madhe, në Shkodër, në Tropojë, nisën të gjallërohen vrasjet për gjakmarrje, në Mirditë ato kanë qenë të pakta dhe shkojnë drejt zhdukjes.

Sigurisht, shpjegimi i këtij fenomeni mund të bëhet më i plotë nga studiuesit e analistët mirditorë. Sipas mendimit tonë, këtu kanë vepruar e veprojnë një sërë faktorësh historikë, shoqërorë, shkollore, kulturorë, fetarë e psikologjikë. Mjafton të merret si model fshati Gëziq, qendër e hershme kulturore, ku rreth 100 vjet nuk ka ndodhur vrasje për gjakmarrje. Veç të tjerash, në Mirditë ka ndikuar ekzistenca për shumë kohë e organizimit të fuqishëm vetëqeverisës, nga ku është kultivuar ndjenja e respektit të shtetit e të ligjeve të tij. Gjithashtu ka ndikuar besëlidhja e Mirditës e vitit 1944 për faljen e gjaqeve. Gjithsesi shembulli pozitiv i Mirditës tregon se gjakmarrja nuk është një fenomen fatalist i pashmangshëm. Kjo le të shërbejë edhe për ato zona ku plaga shoqërore e gjakmarrjes anticivilizuese e antinjerëzore, sjell pasoja të rënda për trevat tona të malësive.

Shpesh në organet e shtypit dhe media të tjera ka një trajtim ekzaltues, empirik, të nxituar të problemit të gjakmarrjes, Kanunit, mungesë njohjeje, teprim në shifrat e të ngujuarve e të tjera. Por edhe reagimi ndaj kësaj inkompetence të shtypit është i rrallë nga studiuesit, psikologët, funksionarët e shtetit për të qartësuar opinionin dhe për të mos e keqinformuar atë. Kjo është e lidhur me faktin pse në shtyp e në mediat e tjera vendase u është dhënë përparësi qëllimeve komerciale, kronikave të zeza, me manipulime shifrash dhe thuajse aspak punës së parandalimit të këtyre dukurive.

Më lejoni ta ilustroj me një shembull konkret. Në Gjykatën e Mirditës para disa vitesh ishin gjykuar 12 vrasje për motive të ndryshme. Sipas shtypit këto paraqiteshin si vrasje për gjakmarrje, ndërsa në të vërtetë ishin vetëm 5 të tilla.

Një gazetë qendrore me shifra të mëdha shkruante se në Shqipëri ishin kryer në një vit 600 vrasje për gjakmarrje, çka absolutisht nuk është e vërtetë. Mbështetur në këtë artikull një gazetë qendrore e huaj shkruan një artikull me titull "Mbretëria e Vdekjes" për Shqipërinë. Kur erdhi në Tiranë artikullshkruesi u sqarua se shkrimi i tij ishte absurd e antishqiptar.

E vërteta është se shumica e madhe e artikujve apo e bisedave në median elektronike për këtë problem bëhen nga njerëz të painformuar mirë, apo inkompetentë e pa përgjegjësi etike e morale.

Detyra e studiuesve, e psikologëve, e sociologëve, juristëve dhe funksionarëve të shtetit është të sqarojë opinionin publik, të qartësojnë nocionet e gjakmarrjes e të hakmarrjes në kuptimin e gjerë të fjalës, si dhe motiveve të tjera të vrasjes, sepse vrasjet për truall nuk janë për gjakmarrje, ashtu sikurse vrasjet për të larë hesapet midis pjesëmarrësve të bandave të armatosura, apo për çështje nderi e të tjera.

Për sa u përket vrasjeve në përgjithësi, për motive të ndryshme, në familje apo në mjediset shoqërore, ato janë fenomene jo vetëm për Mirditën e Shqipërinë, por botërore.

Natyrisht, duke folur posaçërisht për Mirditën ka rëndësi të njihet gjendja, dinamika dhe struktura e këtyre vrasjeve, sa janë p.sh. për motive pronësie, sa për motive të tjera të dobëta. Por kjo nuk mjafton. Për mjekimin e çdo sëmundjeje kërkohet të vihet diagnoza, ashtu edhe për veprat penale duhen njohur e zbuluar shkaqet dhe kushtet favorizuese. Nga analiza e këtyre shkaqeve merren edhe masat parandaluese, që janë hallka vendimtare në luftën kundër kriminalitetit. Në masat parandaluese hyjnë ato që kanë karakter ekonomiko-shoqëror, duke luftuar varfërinë, ulur papunësinë, si dhe masa të tjera që lidhen me çarmatimin e popullsisë, e të tjera.

Nuk ka dyshim se lufta parandaluese kërkon forcimin e rolit të shtetit, ndërtimin e shtetit të së drejtës, funksionimit normal të organeve të policisë, të prokurorisë e të gjykatës për zbulimin, kapjen, hetimin dhe gjykimin e personave fajtorë për vrasjet.

Natyrisht forcimi i shtetit arrihet në bashkëpunimin e tij me shoqërinë civile, me bashkësinë, në një front të përbashkët kundër vrasjeve dhe shkaqeve të tyre.

Literatura

1. Marku, Gjon: "Antologji e mendimit të sotëm për Mirditën". Tiranë, 2009. f.294.
2. Nopça. Franc: "Burimi i Kanunit të Lekë Dukagjinit", në "Djalëria", nr.4.1920.
3. Painsippit, VValther: "Populli i shqipeve të malit", "Mirdita", Tiranë.2005, f. 32.
4. Gjeçovi, Shtjefen: "Kanuni i Lekë Dukagjinit" nyje i pesëdhjetekatërta/217, "Atë Gjergj Fishta", Tiranë, 1993. f .63.
5. Marku, Gjon: "Antologji e mendimit të sotëm për Mirditën". Tiranë, 2009. f.59.
6. Çobani, Tonin: "Princi i përfolur Lekë Dukagjini" "Lisitan", Tiranë, 2003, f .110.
7. Çobani, Tonin: "Princi i përfolur Lekë Dukagjini" "Lisitan", Tiranë, 2003, f .110.
8. Painsippit, VValther: "Populli i shqipeve të malit", "Mirdita", Tiranë, 2005, f .32.
9. Gjeçovi, Shtjefen: "Kanuni i Lekë Dukagjinit" nyje i pesëdhjetekatërta /217, Atë Gjergj Fishta, Tiranë, 1993. f .29.
10. VVlliams & Xhorxh Fred: "Shqiptarët", Argtas-LMG, Tiranë, 1999, f.27.
11. Rose VVilder Lane: "Majat e Shalës" në: "Sfinga" 1993/3,f . 217.
12. Konica, Faik: "Vepra", "Naim Frshëri", Tiranë,1993, f.429.
13. Fishta, Gjergj: "Lahuta e Malcisë," kanga XX. Tiranë, 1994. f. 120.
14. Fishta, Gjergj: "Lahuta e Malcisë," kanga XX. Tiranë, 1994. f. 12.
15. Rose VVilder Lane: "Majat e Shalës" në: "Sfinga" 1993/3, f 14.
16. Rose VVilder Lane: "Majat e Shalës" në: "Sfinga" 1993/3, f . 217.
17. Painsipp, VValter: "Populli i shqipeve të malit". "Mirdita", Tiranë, 2005, f. 10.
18. Mallory and Adams: "Encyclopedia of indo -europjan culture", Londër, 1782 f .205.

GJON MARKU

Studiues, poet e publicist

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj

Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri, Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

MUNDËSUAN BOTIMIN VËLLEZËRIT, ZEF, KRISTJAN E KLAUDIO PALI, ME BANIM NE CUNEO, ITALI